

NJË MËNYRË ALTERNATIVE E
VLERËSIMIT TË POZICIONIT
FISKAL NË RASTIN E
SHQIPËRISË: BALANCA
BUXHETORE E KORREKTUAR
PËR CIKLET E BIZNESIT

Anjeza Gazidede*

05 (64) 2013

MATERIAL DISKUTIM

BANKA E SHQIPËRISË



**Anjeza Gazidede, kryespecialiste në Departamentin e Politikës Monetare,
Banka e Shqipërisë,
e-mail: agazidede@bankofalbania.org*

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autores dhe nuk përfaqësojnë
domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

*Autorja falënderon z. Erald Themeli për komentet dhe sugjerimet e vlefshme gjatë
përgatitjes së këtij materiali.*

PËRMBAJTJA

<i>Abstrakt</i>	5
<i>1. Hyrje</i>	6
<i>2. Përmbledhje e literaturës – avantazhe dhe disavantazhe</i>	9
<i>3. Metodologjia e përdorur dhe rezultatet nga llogaritja e BKC-së në rastin e Shqipërisë</i>	18
<i>4. BKC dhe politika fiskale</i>	36
<i>5. Përfundime</i>	46
<i>Shkurtime</i>	48
<i>Literatura</i>	49

ABSTRAKT

Ky material synon të shërbejë si një pikënisje drejt ndjekjes së një mënyre alternative për analizimin dhe monitorimin e pozicionit fiskal në vend. Përqasja e ndjekur për vlerësimin e pozicionit fiskal në Shqipëri përgjithësisht i referohet treguesve buxhetorë të shprehur në vlerë nominale, të cilët mbartin në vetvete dhe efekte të shkaktuara nga faktorë me natyrë të përkohshme në ekonomi, e që mund të dalin përtej fushës së ndikimit të politikës fiskale. Për të vlerësuar pozicionin fiskal në rastin e Shqipërisë është propozuar një mënyrë alternative, e cila mundëson llogaritjen e balancës buxhetore të korrektuar për ciklet e biznesit, duke evidentuar vetëm efektet e politikës fiskale diskrecionare mbi balancën buxhetore, nëpërmjet zbutjes apo eliminimit të efektit të shkaktuar nga faktorët ciklikë mbi treguesit buxhetorë. Bazuar në rezultatet e përfuara për këtë tregues vlerësohet që politika fiskale në Shqipëri në më të shumtat e rasteve ka qenë prociklike. Stabilizatorët automatikë, ndonëse në madhësi të moderuar, kanë vepruar në ekonomi përgjatë periudhës së analizuar.

Fjalët kyçe: Balancë buxhetore e korrektuar për ciklet e biznesit, sensitivitet buxhetor, pozicion fiskal, stabilizatorë automatikë, politikë fiskale.

JEL Classification: E60, E62, H62, H69.

1. HYRJE

Monitorimi i kornizës fiskale të një vendi merr rëndësi të madhe, sidomos nën dritën e zhvillimeve më të fundit të ekonomive të vendeve të ndryshme të botës. Kriza globale që preku të gjitha ekonomitë e vendeve të zhvilluara dhe të atyre në zhvillim, bëri të domosdoshëm analizimin më të hollësishëm të përcaktuesve kryesorë që përkeqësuan pozicionet fiskale. Pas vitit 2008, deficitet buxhetore, e për rrjedhojë dhe borxhet publike janë rritur me ritme të shpejta, jo vetëm si pasojë e stimuljeve të ndryshëm fiskalë¹, por edhe si rezultat i veprimit të stabilizatorëve automatikë². Evidentimi i faktorëve me efekt të përkohshëm mbi pozicionin fiskal dhe përcaktimi i madhësisë së veprimit të tyre ka një rëndësi të veçantë për politikëbërësit. Kjo për arsye se faktorët që përkeqësojnë përkohësisht pozicionin fiskal, nuk kërkojnë ndërhyrje të autoritetit fiskal e monetar “për të neutralizuar” efektin e tyre, pasi siç sugjerohet nga literatura ekonomike, ato nuk kanë implikime të qenësishme në dinamikën e borxhit publik apo për pritjet mbi normën e interesit në treg. Për këtë arsye, kuptimi i masave të përhershme apo të përkohshme të ndërmarra nga autoriteti fiskal ka një rëndësi të lartë dhe për bankën qendrore në përmbushjen e funksioneve të saj.

Balancat buxhetore të shprehura në terma nominalë ndikohen dhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, me natyrë të përkohshme dhe jashtë ndikimit të politikës fiskale, duke dhënë kështu sinjale jo të sakta mbi pozicionin fiskal të një vendi. Një ndër mënyrat më optimale për vlerësimin e politikës fiskale dhe të implikimeve të saj të mundshme në pozicionin fiskal të një vendi, do të ishte dhe llogaritja e balancës buxhetore të korrigjuar për ciklet e biznesit³ (BKC). Ky indikator reflekton vetëm efektet e politikës fiskale

¹ Stimujt e shumtë fiskalë të ndërmarrë nga vende të ndryshme synuan rimëkëmbjen e sistemit financiar, gjallërimin e kërkesës agregate, si edhe rivendosjen e besimit në tregjet financiare.

² Me stabilizatorë automatikë nënkuptohen ato mekanizma që stimulojnë ose kontraktjnë ekonominë në momentet e duhura, pa patur nevojën e një ndryshimi në politikat ekonomike të vendit në atë periudhë kohore (Macroeconomics, 5th editon, pg 382 (Mankiw, G.).

³ Cikle biznesi përkufizohen luhatjet e përkohshme në nivelin e prodhimit dhe të normës së papunësisë (Macroeconomics, 5th edition, pg 238 (Mankiw, G.).

diskrecionare, duke zbutur apo eliminuar ndikimin e luhatjeve ciklike mbi treguesit fiskalë. E thënë ndryshe, BKC ofron një vlerësim mbi balancën buxhetore, që do të rezultonte nëse ekonomia do të ndiqte trajektoren normale të saj⁴.

BKC luan një rol mjaft të rëndësishëm në mbikëqyrjen fiskale brenda Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (EMU). Para vitit 2005, BKC shërbente si një instrument analitik për të vlerësuar pozicionin fiskal të një vendi. Me rishikimin e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes (SGP), në vitin 2005, BKC u pozicionua si elementi bazë i kornizës së mbikëqyrjes fiskale të vendeve të EMU-së.

BKC është prezantuar fillimisht nga Blanchard (1990), i cili propozoi këtë indikator për të dalluar nga njëri-tjetri efektin e dy faktorëve që ndikojnë njëherazi në rritjen apo reduktimin e deficitit buxhetor, të cilët janë ecuria e aktivitetit ekonomik dhe politika fiskale në vend. Ekzistojnë disa metodologji të cilave i referohen vende të ndryshme për llogaritjen e BKC-së. Më të përdorurat janë ato të paraqitura nga OECD dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE). Për vlerësimin e BKC-së në rastin e Shqipërisë është ndjekur një trajtë më e thjeshtuar e metodologjisë së OECD-së, e cila jepet e detajuar në vijim.

Gjithsesi, duhet theksuar se gjatë episodeve të veçanta ekonomike apo politike, BKC mbart disavantazhe si në mënyrën e llogaritjes ashtu dhe të interpretimit të saj. Duke qenë se llogaritjet e këtij indikator bazohen në vlerësimin e hendekut të prodhimit, elasticitetit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore ndaj hendekut të prodhimit, rezultatet janë gjithmonë të diskutueshme dhe subjekt rishikimi. Problemet lidhur me llogaritjen e tij përcillen dhe në mënyrën e interpretimit të këtij indikator: si tregues i politikës fiskale diskrecionare; i pozicionit fiskal; si edhe si tregues i qëndrueshmërisë fiskale. Megjithatë, mënyra më e mirë për të përfituar nga avantazhet që sjell ky indikator do të ishte "bashkëjetesa me kompromise", si për mënyrën e llogaritjes ashtu edhe të interpretimit të tij, Larch dhe Turrini (2009).

⁴ Sipas Bouthevillain et al, (2001), ekonomia konsiderohet të ndjekë trajektoren normale të saj nëse PBB do të njihet një rritje konstante në periudhën afatmesme.

Nëpërmjet këtij materiali, ndër të tjera synohet paraqitja e një mënyre të thjeshtë vlerësimi për BKC-në, ndërkohë që procesi i vlerësimit të këtij indikator në vetvete lë hapësira të konsiderueshme për gjykime analitike, nisur nga kufizimet që ka krijuar disponueshmëria e të dhënave në kohën e përgatitjes së tij. Struktura e studimit bazohet në tre seksione kryesore, të cilat sipas radhës së trajtimit janë: vështrim mbi literaturën ekonomike rreth BKC-së, duke evidentuar avantazhet dhe disavantazhet që mbart ky indikator; mënyra e ndjekur për llogaritjen e këtij treguesi në rastin e Shqipërisë, si edhe rezultatet e përfutuara nga kjo përjasje për vlerësimin e pozicionit fiskal. Në pjesën e tretë, bazuar në vlerësimet për BKC-në, janë analizuar pozicioni fiskal si edhe kahu i veprimit të politikës fiskale. Së fundmi, jepen përfundimet që burojnë nga vlerësimet mbi BKC-në, duke shprehur shkurtimisht dhe fokusin e punës së ardhshme lidhur me vlerësimin më të saktë të këtij treguesi të politikës fiskale.

2. PËRMBLEDHJE E LITERATURËS – AVANTAZHE DHE DISAVANTAZHE

Ekziston një gamë mjaft e gjerë literature, e cila frymëzuar nga idetë e Keynesit, është fokusuar në identifikimin e faktorëve me ndikim të përkohshëm në ekonomi. BKC është një prej indikatorëve i cili evidenton vetëm ndryshimet me impakt të përhershëm, e që janë pasojë e politikës fiskale diskrecionare. Fillimisht, BKC është propozuar nga Blanchard (1990) për të vlerësuar qëndrueshmërinë fiskale të një vendi në periudhën afatgjatë. Literatura e mëvonshme, që ka pasuar Blanchard, sugjeron përdorimin e këtij indikator dhe në procese e situata të tjera, të cilat do të trajtohen në vijim.

2.1. PSE JANË TË RËNDËSISHME VLERËSIMET PËR BKC-NË?

Performanca e treguesve fiskalë është e lidhur ngushtë me aktivitetin ekonomik në vend. Gjatë një cikli biznesi, ku aktiviteti ekonomik rezulton poshtë nivelit potencial të tij, deficitit buxhetor mund të rritet pavarësisht një politike fiskale të pandryshuar. Rritja e deficitit buxhetor mund të vijë nga një kombinim i rënies së të ardhurave me rritje të shpenzimeve buxhetore (mund të jetë dhe rasti kur secili prej këtyre faktorëve më vete mund të shkaktojë rritjen e deficitit buxhetor), si rezultat i stabilizatorëve automatikë që veprojnë në ekonomi. Për ta ilustruar, gjatë këtyre periudhave, të ardhurat personale pësojnë rënie (pasi një pjesë e forcës së aftë për punë mund të humbë punën) ose të ardhurat nga fitimet e bizneseve mund të bien si pasojë e rënies së shitjeve, e për rrjedhojë niveli i të ardhurave për qeverinë që lidhen me këto lloj taksash pëson rënie, pavarësisht faktit se legjislacioni tatimor nuk ka ndryshuar. Gjithashtu, shpenzimet publike gjatë këtyre episodeve rriten në krahasim me periudhat kur ekonomia rezulton në nivelin e saj potencial, pasi rriten kryesisht shpenzimet e lidhura me papunësinë. Kuptimi dhe matja e saktë e luhatjeve ekonomike me natyrë të përkohshme, ka një ndikim të rëndësishëm në analizimin dhe vlerësimin e zhvillimeve fiskale.

Treguesit fiskalë të shprehur në vlerë nominale nuk japin gjithmonë saktë orientimin e politikës fiskale, për sa kohë ata përfaqësojnë efektet e përkohshme (nga ciklet e biznesit - siç u ilustrua në paragrafin më lart) dhe ato të përhershme (nga vendimet e autoritetit fiskal) së bashku. E thënë ndryshe, balancat buxhetore të shprehura në vlerë nominale ndikohen njëherazi nga faktorët ciklikë, si edhe nga politika fiskale diskrecionare, e cila në vetvete mund të përfshijë dhe masa strukturore. Për këtë arsye, nuk mund të perceptohet saktë orientimi i politikës fiskale ose pozicionimi fiskal i një vendi, ashtu sikurse nuk mund të evidentohen disbalancat strukturore të sektorit publik. Rëndësia e përdorimit të BKC-së përkundrejt treguesve nominalë shprehet në mënyrë eksplicite në vijim, nëpërmjet avantazheve të evidentuara nga literatura ekonomike.

2.2. AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E BKC-SË

Trajtimi i përparësive që ofron BKC ka qenë subjekt i një game të gjerë pune kërkimore, të cilat nga autorë të ndryshëm janë evidentuar si: (i) indikator për monitorimin e pozicionit fiskal; (ii) tregues i qëndrueshmërisë fiskale; (iii) rregull fiskal për ekonominë; (iv) indeks për vlerësimin e efektit të politikës fiskale mbi kërkesën agregate apo kursimet; (v) BKC në funksion të vendimmarrjes. Në të njëjtën kohë, dhe disavantazhet e këtij indikatori janë trajtuar gjerësisht në literaturën ekonomike. Reis et.al (2007) kanë analizuar me detaje disavantazhet e këtij treguesi, si për mënyrën e llogaritjes, ashtu edhe të interpretimit të tij.

2.2.1. BKC SI NJË INDEKS I POZICIONIT FISKAL

Një prej avantazheve që ofron llogaritja e BKC-së, sikurse argumentohet dhe nga Blanchard (1990), është evidentimi i ndryshimeve mbi pozicionin fiskal që shkaktohen nga masat e ndërmarra nga autoriteti fiskal (si për shembull, nëpërmjet ndryshimit të taksave, rritjes apo uljes së shpenzimeve). Nëpërmjet vlerësimit të BKC-së, efekti i cikleve të biznesit mbi pozicionin fiskal të një vendi vjen më i zbutur ose eliminohet. Në këtë mënyrë, evidentohen vetëm ndryshimet që vijnë si pasojë e politikës fiskale diskrecionare gjatë një periudhe kohe të caktuar.

Gjithsesi, mbështetur në argumentet e Larch dhe Turrini (2009), duhet theksuar se ndryshimet në BKC matin efektin e politikës fiskale diskrecionare nën dy supozime të rëndësishme, të cilat janë parashikimi i saktë i hendekut të prodhimit, si edhe fleksibiliteti i shpenzimeve buxhetore (për shembull, korrektimi i planit të shpenzimeve jodiclike në varësi të rritjes ekonomike). Ndërsa Reis et.al (2007), argumentojnë që BKC mund të përdoret për të evidentuar komponentin strukturor të balancës buxhetore vetëm nën supozimin që goditjet në trendin stokastik nuk janë të pranishme. Goditjet në trendin stokastik dhe thyerjet strukturore bëjnë që BKC të mos jetë indikator i duhur në vlerësimin e pozicionit fiskal të një vendi.

Ekspierienca ka treguar se ka pasur divergjencë në mënyrën e interpretimit të BKC-së si një tregues i politikës fiskale diskrecionare. Rast specifik përbën monitorimi i korrektimit fiskal në fillimet e viteve 2000 në vendet e Bashkimit Evropian (BE). Gjatë këtij procesi, sikurse trajtohet dhe nga Larch e Turrini (2009)⁵, pati interpretime të ndryshme të rezultateve lidhur me masën e korrektimit fiskal, nga vendet anëtare të BE-së që regjistronin tejkalim të kufijve të përcaktuar në SGP mbi treguesit fiskalë dhe Komisionit Evropian (KE). Vendet anëtare të BE-së argumentonin ecurinë e politikës fiskale brenda limiteve të përcaktuara në planet e tyre vjetore, në përputhje me programet e konvergencës dhe stabilitetit. Në të kundërt, KE argumentonte se këto vende kishin ndjekur politikë fiskale ekspansioniste duke ia faturuar zgjerimin e deficitit buxhetor, rritjes së shpenzimeve diskrecionare që ato kishin njohur. Interpretimet jo të njëjta mbi masën e korrektimit fiskal buronin nga vlerësimet e ndryshme të secilës palë për hendekun e prodhimit. Në rastin e vendeve anëtare të BE-së, rritja reale ekonomike në terma afatmesëm ishte e prirur të mbivlerësohej. Në këtë mënyrë, roli i BKC-së në monitorimin e saktë të pozicionit fiskal dobësohej, pavarësisht faktit se realizimi i shpenzimeve buxhetore përputhej me planet e hartuara nga qeveritë e vendeve përkatëse.

Një moment tjetër mjaft i rëndësishëm në vlerësimin e pozicionit fiskal të një vendi është matja e efektit të masave të përkohshme. Këto masa, sipas *Code of Conduct* të BE-së, përkufizohen si masa

⁵ Për detaje referojuni Larch dhe Turrini (2009) f. 9-17.

me efekt të përkohshëm, që nuk sjellin ndryshim të qëndrueshëm në pozicionin buxhetor ndërkohor⁶. Teorikisht, këto masa ndahen në masa që sjellin rritjen ose uljen e deficitit të përgjithshëm. Eksperienca ka treguar se më së shumti këto masa kanë synuar përmirësimin e deficitit fiskal (BE, 2006). Përdorimi i vazhdueshëm i këtyre masave dhe pamundësia për të evidentuar në mënyrë të saktë madhësinë e tyre, ka vështirësuar shpeshherë respektimin e rregullave të përcaktuara në SGP. Rast specifik përbën periudha nga viti 2000 deri në 2004, gjatë së cilës pozicionet fiskale u përkeqësuan si pasojë e ngadalësimit ekonomik të vërejtur në vendet e BE-së. Bazuar në supozimin që ekonomitë e tyre do t'i riktheheshin sërish një trajektoreje rritëse (sikurse ajo e fundviteve '90), shumë vende morën masa të përkohshme që ndikuan në rritjen e mëtejshme të deficitit, i cili në shumicën e rasteve tejkalonte dhe kufirin prej 3% të PBB-së. Me rritjen e numrit të masave të karakterit të përkohshëm, situata e mbikëqyrjes fiskale u vështirësua, pasi ishte vështirë të evidentoheshin ndikimi i tyre mbi treguesit buxhetorë.

2.2.2. BKC SI INDEKS I QËNDRUESHMËRISË FISKALE

Nëse i referohemi literaturës ekonomike, nuk ekziston një përkufizim i vetëm për qëndrueshmërinë fiskale, ndonëse në thelb ky term i referohet vetëm politikës fiskale të ndjekur nga një vend i caktuar. Sipas Croce (2002), financat publike konsiderohen të qëndrueshme nëse vlera e skontuar për suficitet primare në të ardhmen barazon vlerën e stokut të borxhit aktual të zotëruar nga qeveria. Një përkufizim tjetër i qëndrueshmërisë fiskale lidhet me aftësinë paguese të një vendi. Sipas tij, një vend gëzon qëndrueshmëri fiskale nëse qeveria është e aftë të shlyejë detyrimet e saj në vazhdimësi, pa iu nënshtruar korrektiveve jorealiste mbi të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore. Ndërsa përkufizimi tjetër i referohet implikimeve në të ardhmen të politikës aktuale të ndjekur në sferën fiskale, e më konkretisht i referohet pyetjes nëse qeveria mund të vazhdojë ndjekjen e politikave buxhetore aktuale pa cënuar aftësinë paguese të vendit (FMN, 2002). Akyüz (2005), sugjeron që për t'i vendosur financat publike brenda një trajektoreje të qëndrueshme duhet të mos bëhet fjalë për skemën Ponzi (Ponzi

⁶ Në literaturën ekonomike, këto masa hasen si *one-off measures*. Për detaje lidhur me përkufizimin e këtij termi referojuni Public finances in EMU, 2006, f. 112-113.

game) në financimin e deficitit buxhetor⁷. Nëse do të bënim një përmbledhje të përkufizimeve të ndryshme, financat publike të një vendi konsiderohen të qëndrueshme, nëse ndjekja e një politike fiskale të njëjtë në kohë, nuk do të kërkonte korrektime fiskale në të ardhmen (rritje taksash apo ulje shpenzimesh), pavarësisht kushteve të jashtme të pandryhuara; monetizim të borxhit (printim të parasë nga ana e Bankës Qendrore në masën e borxhit të zotëruar nga qeveria); apo ristrukturim të borxhit.

Metodat e ndryshme për vlerësimin e qëndrueshmërisë fiskale të një vendi i referohen më së shumti deficitit të përgjithshëm apo dhe balancës primare⁸. Referimi ndaj BKC-së si ancorë e politikës fiskale, përkundrejt balancës buxhetore në vlerë nominale, do t'i shërbente më shumë objektivit final të autoritetit fiskal, qëndrueshmërisë fiskale. Në këtë kuadër, duke eliminuar efektin e goditjeve të përkohshme që vijnë mbi balancën buxhetore, mund të vlerësohet nëse një masë e lartë deficiti buxhetor mund "të zhduket" vetvetiu me kalimin e kohës apo nëse këtij vendi do t'i nevojitej një korrektim i konsiderueshëm fiskal në shërbim të financave publike të qëndrueshme.

Megjithatë, as disavantazhet e BKC-së si një indeks i qëndrueshmërisë fiskale nuk mungojnë. Blanchard (1990) evidenton dy mangësi të këtij indikatorit në vlerësimin e qëndrueshmërisë fiskale të një vendi. E para lidhet me praninë e faktorëve të tjerë, që dalin përtej fushës së veprimit të drejtpërdrejtë të politikës fiskale, e që ndikojnë mbi masën e borxhit publik të një vendi, si për shembull, ndryshimet në normën e inflacionit dhe normën reale të interesit. Gjithashtu, ka dhe faktorë të tjerë, siç janë plakja e popullsisë, një fenomen i cili po analizohet së tepërmi nga vendet e EU-së së fundmi, apo dhe përbërja e popullsisë (forcë e aftë apo jo e aftë për punë), të cilët ndikojnë në shpenzimet buxhetore në të ardhmen, duke qenë faktorë kyç me ndikim në qëndrueshmërinë fiskale të një vendi. Ndërsa mangësia e dytë lidhet me vlerësimet

⁷ Skema Ponzi (Ponzi game) mund të përkufizohet si një proces, ku interesat mbi stokun e borxhit publik paguhen nëpërmjet huamarrjes së re, e cila nga ana tjetër mund të çojë në shpërthimin e borxhit. Një përkufizim tjetër alternativ vjen dhe nga Croce, et al (2002), të cilët argumentojnë se mungesa e skemës Ponzi ndodh në rastet kur suficiti primar është i mjaftueshëm për të paguar interesat mbi borxhin publik.

⁸ Balanca primare është deficiti i përgjithshëm i korrektuar me shpenzimet për interesa.

mbi të ardhmen për qëndrueshmërinë e borxhit, sidomos në rastet kur prania e paqartësive në ambientin ekonomik të një vendi, sjell implikime të mëdha në treguesit buxhetorë gjatë një periudhe të caktuar kohore.

2.2.3. BKC SI RREGULL FISKAL

BKC mund të shërbejë si rregull fiskal, i implementuar në kuadër të rritjes së kredibilitetit dhe disiplinës fiskale. Kopitz dhe Symansky (1998) përkufizojnë si rregull fiskal një kufizim të përhershëm mbi politikën fiskale, i cili vendoset nëpërmjet një limiti numerik për treguesit buxhetorë. Rregullat fiskalë mund të formulohen në terma të deficitit buxhetor, të shpenzimeve, të të ardhurave fiskale apo dhe të borxhit publik (ose në ndonjë formë alternative të secilit prej tyre, siç janë balanca primare apo shpenzimet kapitale). Qëllimi kryesor i rregullit fiskal është të sigurojë ulje të stokut të borxhit publik, duke mundësuar në të njëjtën kohë krijimin e hapësirave të nevojshme për ndjekjen e një politike fiskale kundërciklike⁹. Nisur nga përkufizimi i qëndrueshmërisë fiskale, gjykojmë se BKC është indikator më i përafërt që plotëson kriterin e eficiencës së një rregulli fiskal, në funksion të financave publike të qëndrueshme. Eksperienca botërore tregon se ka një trend në rritje të rregullave fiskale të hartuara në terma të BKC-së¹⁰.

Vlerësimi i pozicionit fiskal të një vendi ndër të tjera adreson dhe dy pyetje: (i) “Në kushtet e luhatjeve normale ciklike në ekonomi, sa i lartë është rreziku që brenda një viti të caktuar të tejkalohet kufiri i miratuar për deficitin buxhetor?”; dhe (ii) “Sa larg paraqitet balanca buxhetore nga objektivi që garanton qëndrueshmëri të financave publike në periudhën afatgjatë?”. Në të dyja rastet, vlerësimi i BKC-së luan rol thelbësor. Në rastin e parë, përcaktohet niveli minimal i BKC-së, i cili në kushtet e luhatjeve normale ciklike siguron që veprimi i stabilizatorëve automatikë të lejojë deficitin

⁹ Bazuar në përkufizimin e Alessina dhe Tabellini (2005), politikë fiskale kundërciklike kemi në rastet kur gjatë një episodi të rritjes ekonomike mbi potencialin e saj (periudhë boom-i), suficiti buxhetor rritet, dhe e anasjellta.

¹⁰ Për detaje shih FMN (2009), “Fiscal Rules—Anchoring Expectations for Sustainable Public Finances”.

buxhetor në raport të PBB-së të jetë brenda kufirit të përcaktuar¹¹. Ndërsa në rastin e dytë, BKC tregon qartë se objektivi buxhetor i përcaktuar për një periudhë afatmesme përcaktohet në terma strukturorë, që do të thotë se në llogaritjen e objektivit nuk merren parasysh faktorët ciklikë dhe ata të përkohshëm. Gjithsesi, optimaliteti i kësaj forme të mbikëqyrjes fiskale do të varej nga shkalla e monitorimit dhe zbatueshmërisë së BKC-së. Madje në rrethana të caktuara sikurse argumentojnë Reis et. al (2007), BKC përveç se mund të rezultojë jo eficient si një rregull fiskal, mund edhe të jetë i dëmshëm për ekonominë.

2.2.4. BKC SI INDEKS I NDIKIMIT TË POLITIKËS FISKALE MBI KËRKESËN AGREGATE OSE KURSIMET

Sipas propozimit të Blanchard (1990), ndryshimi vjetor i BKC-së reflekton ndikimin e politikës fiskale diskrecionare mbi kërkesën agregate. Teorikisht, politika fiskale mund të ndikojë kërkesën agregate nëpërmjet dy kanaleve. Së pari, politika fiskale përcakton nivelin e shpenzimeve korrente, si edhe të investimeve publike. Shpenzimet korrente (që përafrojnë konsumin final të qeverisë), si edhe investimet publike janë komponentë përbërës të kërkesës agregate. Së dyti, taksat dhe niveli i borxhit ndikojnë kërkesën agregate nëpërmjet konsumit privat. Duke përjashtuar efektin e përkohshëm të stabilizatorëve automatikë, evidentohet më qartë efekti i politikës fiskale diskrecionare mbi kërkesën agregate.

Megjithatë, sikurse argumenton Blanchard (1990), duhet theksuar se BKC evidenton direkt efektin e politikës fiskale mbi kërkesën agregate apo kursimet, nën dy supozime të cilat janë: (i) prirja marxhinale për konsum duhet të jetë e barabartë me 1, në mënyrë që ndryshimi në taksat të reflektohet në të njëjtën masë në kërkesën agregate; (ii) konsumi privat aktual varet vetëm nga të ardhurat korrente, pra supozohet që pritet ashtu sikurse dhe çmimet e aktiveve të mos kenë ndikim mbi konsumin aktual. Megjithatë, praktikisht është mjaft i vështirë evidentimi i saktë i efektit të politikës fiskale mbi kërkesën agregate, pasi prirja marxhinale për konsum është më e vogël se 1 (sepse një pjesë e

¹¹ Për vendet e BE-së ky kufi është 3% e PBB-së. Në rastin e Shqipërisë nuk ekziston një kufi i sipërm për masën e deficitit buxhetor.

të ardhurave aktuale kalojnë në trajtë kursimesh për konsum në të ardhmen), duke bërë që ndryshimet në taksa të mos reflektohen në të njëjtën masë në kërkesën agregate. Në të njëjtën kohë, në mënyrë që supozimi i dytë të plotësohet, duhet që konsumatorët të mos shfaqin sjellje Rikardiane¹², gjë e cila vështirë të haset në një botë, ku pritjet luajnë rol kyç në zhvillimet ekonomike dhe përçimin e vendimeve të politikëbërësve në ekonomi.

2.2.5. BKC NË FUNKSION TË VENDIMMARRJES

Matja dhe vlerësimi i efekteve ekonomike që vijjnë si pasojë e luhatjeve të përkohshme në nivelin e prodhimit dhe punësimit¹³, janë thelbësore për vendimmarrjen. Duhet theksuar se në funksion të vendimmarrjes kanë rëndësi të lartë faktorët me natyrë të përhershme në ekonomi, duke lënë jashtë fokusit efektet e përkohshme që vijjnë nga goditje të ndryshme në ekonomi. Meqenëse vendimet në sferën e politikës fiskale i shtrijnë efektet mbi financat publike për një periudhë shumëvjeçare, një ndryshim në BKC mund të përdoret si një instrument paralajmërimi për nevojat e korrektimit fiskal dhe ndryshimet e ardhshme në kahun e politikës fiskale. Llogaritja e BKC-së ofron informacion të dobishëm dhe për zbatimin e politikës monetare, pasi vlerësimet për politikën fiskale diskrecionare janë një nga shtyllat kryesore ku bazohen vendimet e bankave qendrore.

Megjithatë, praktika ka treguar se BKC jo gjithnjë ka dhënë sinjale të sakta mbi pozicionin fiskal të një vendi, duke shtyrë në këtë mënyrë autoritetet fiskale drejt vendimeve jo të duhura. Ky rast është hasur pikërisht në fund të viteve '90, periudhë e cila përbënte fillimet e formalizimit të SGP-së. Gjatë këtyre viteve, vendet e BE-së gëzonin pozicione të favorshme fiskale, si pasojë e korrektimeve fiskale të ndërmarra prej tyre, në kuadër të kalimit drejt adoptimit të një monedhe të vetme, e cila u shoqërua në të njëjtën kohë dhe me një rritje ekonomike relativisht të lartë dhe të ardhura tatimore të larta. Në këto kushte, nuk shihej ndonjë rrezik i

¹² Konsumatorët në një botë ku plotësohet Kriteri i Ekuivalencës Rikardiane i bazojnë shpenzimet e tyre jo vetëm në nivelin korrent të të ardhurave, por edhe në atë të pritur në të ardhmen (Macroeconomics, 5th edition, f. 415 (Mankiw, G.).

¹³ Gjithsesi, luhatjet janë më evidente në nivelin e prodhimit duke qenë se tregu i punës është "i ngurtë" në periudhën afatshkurtër.

mundshëm për mospërmbushjen e detyrimeve që lindnin nga SGP, dhe veçanërisht të dhënat për BKC-në e vendeve anëtare të BE-së sinjalizonin pozicione fiskale të shëndetshme. Nën supozimin se rritja ekonomike që kishin njohur këto vende deri në atë kohë do të vazhdonte të paktën dhe për një periudhë afatmesme, si edhe vjelja e taksave do të ishte po aq e kënaqshme sa dhe në periudhën përmbyllëse të viteve '90, disa vende filluan të zbatonin reduktimin e taksave. Megjithatë, sikurse e trajtojnë dhe Larch e Turrini (2009), shumë shpejt rezultoi që ulja e taksave nuk ishte vendimi i duhur, sepse perspektiva fiskale si edhe supozimet për rritjen ekonomike ishin të gabuara. Më vonë u vërtetua që për shumë vende, situata fiskale nuk ishte aq optimiste sa dukej dhe realisht deficitet buxhetore të këtyre vendeve ishin në vlera më të larta nga ato të vlerësuara për vitet 2000.

Pavarësisht disavantazheve që ky indikator mbart, mënyra më e mirë për të përfituar nga përparësitë e tij është ndjekja e mënyrave që i rrisin eficiencën. Për rastin e BE-së, Larch dhe Turrini (2009) propozojnë disa hapa konkretë që mund të ndërmerren në rastet ku janë evidentuar mangësi të këtij indikator: si për shembull, gjatë procesit të konsolidimit fiskal; evidentimit të luhatjeve afatshkurtra në elasticitetin e taksave; si edhe në procesin e llogaritjes së masave me karakter të përkohshëm¹⁴. Teorikisht, këto propozime mund të gjejnë përdorim dhe në rastin e Shqipërisë, sidomos gjatë procesit të monitorimit të politikës fiskale në vend.

¹⁴ Për detaje referojuni Larch dhe Turrini (2009), f. 18-28.

3. METODOLOGJIA E PËRDORUR DHE REZULTATET NGA LLOGARITJA E BKC-SË NË RASTIN E SHQIPËRISË

Eksperienca botërore ofron mënyra të ndryshme për të përkthyer llogaritjen e BKC-së dhe procesin e vlerësimit të saj kalon nëpërmjet 3 etapave kryesore. Këto etapa sipas radhës janë identifikimi i zërave buxhetorë të ndjeshëm ndaj luhatjeve ciklike në ekonomi; vlerësimi i hendekut të prodhimit; si edhe llogaritja e elasticitetit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore (pas përcaktimit të bazës së tyre respektive makroekonomike), kombinimi i të cilave në fund jep vlerësimin mbi komponentin ciklik të balancës buxhetore.

Metodologjitë më të përdorura janë ato të prezantuara nga OECD dhe BQE. Nisur nga disponibiliteti i të dhënave të kërkuara nga secila prej metodologjive, në rastin tonë kemi aplikuar një trajtë më të thjeshtuar të metodologjisë së OECD-së, e cila në literaturë haset dhe me termin “përqasja e disagreguar”. Kjo përqasje, pavarësisht faktit se kërkon një gamë më të gjerë të dhënash, ofron më shumë avantazhe sesa përqasja e agreguar (metodologjia e BQE-së), në terma të rezultateve më të qëndrueshme, pasi merr në konsideratë reagueshmërinë ndaj ciklit të biznesit të zërave të veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.1. MËNYRA E NDJEKUR

OECD në llogaritjen e BKC-së ndjek 3 hapa kryesorë: (i) vlerësimin e koeficientëve të elasticitetit të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të ndjeshme nga luhatjet ciklike në ekonomi, (ii) vlerësimin e hendekut të prodhimit; dhe (iii) vlerësimin e komponentit ciklik të balancës buxhetore. BKC-në e llogarisim sipas formulës:

$$BKC = BB - \varepsilon OG$$

BB: balanca buxhetore,
 ε : koeficienti i sensitivitetit buxhetor,
OG: hendeku i prodhimit¹⁵.

¹⁵ $OG = (PBB_{aktuale} - PBB_{potenciale}) / PBB_{potenciale}$.

Termi ε_{OG} përbën komponentin ciklik të balancës buxhetore. Nga ana tjetër, koeficienti i sensitivitetit buxhetor, ε , derivohet nga diferenca e sensitivitetit të të ardhurave ε_R , me atë të shpenzimeve ε_G .

$$\varepsilon = \varepsilon_R - \varepsilon_G$$

Secili prej koeficientëve të sensitivitetit, të cilët tregojnë se sa të ndjeshme janë të ardhurat tatimore apo shpenzimet korrente primare ndaj ndryshimeve në hendekun e prodhimit, llogaritet në bazë të formulave si më poshtë:

$$\varepsilon_R = \eta_R \frac{R}{Y} \quad \varepsilon_G = \eta_G \frac{G}{Y}$$

Ku:

η_R është elasticiteti i të ardhurave tatimore ndaj hendekut të prodhimit,

η_G elasticiteti i shpenzimeve korrente primare ndaj hendekut të prodhimit,

$\frac{R}{Y}$: raporti i të ardhurave tatimore ndaj PBB-së,

$\frac{G}{Y}$: raporti i shpenzimeve primare korrente ndaj PBB-së.

3.2. IDENTIFIKIMI I ZËRAVE BUXHETORË QË NDIKOHEN NGA CIKLET E BIZNESIT

Në hapin e parë është thelbësor përcaktimi i saktë i zërave buxhetorë të cilët supozohet të ndikohen nga luhatjet ciklike në ekonomi. Në rastin e Shqipërisë, bazuar në detajimin e zërave fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, kemi supozuar që të ardhurat që ndikohen nga luhatjet ciklike në ekonomi janë:

- Të ardhurat nga taksimi indirekt, të cilat i kemi përafëruar me të ardhurat nga TVSh-ja, akcizat dhe taksat doganore (IT);
- Tatimi mbi të ardhurat personale (PIT);
- Tatimi mbi fitimet e kompanive (të bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha) (CIT);
- Kontributet sociale (sigurimet shoqërore e shëndetësore) (SSC).

Ndërsa në kahun e shpenzimeve buxhetore, zëri i vetëm i cili vlerësohet të ndikohet nga luhatjet ciklike në ekonomi është zëri i shpenzimeve për papunësinë.

Për të agreguar në një të vetëm elasticitetin e të ardhurave nga taksat, shërben formula e mëposhtme:

$$\eta_R = \sum_{i=1}^4 \eta_{R,i} \frac{R_i}{R}$$

Për këtë qëllim duhet të ndërtohen 4 elasticitete, respektivisht për zërat e të ardhurave personale; të ardhurave nga kontributet sociale; të ardhurave nga fitimet e kompanive; si edhe të ardhurave nga taksimi indirekt (IT).

$\eta_{R,i}$ përfaqëson elasticitetin e secilit zë të tatimor ndaj hendekut të prodhimit,

$\frac{R_i}{R}$: është raporti i secilit zë të të ardhurave të marrë në konsideratë (IT, PIT, CIT dhe SSC) ndaj totalit të të ardhurave tatimore.

Ndërsa elasticiteti i shpenzimeve buxhetore, përcaktohet sipas formulës:

$$\eta_G = \eta_{G,U} \frac{G_u}{G}$$

$\eta_{G,U}$: elasticiteti i shpenzimeve për papunësinë ndaj hendekut të prodhimit,

$\frac{G_u}{G}$: raporti i shpenzimeve për papunësinë ndaj shpenzimeve primare korrente.

3.3. TË DHËNAT

Frekuenca e të dhënave të përdorura në vlerësimin e BKC-së është 3-mujore dhe mbulojnë periudhën 2005-2012. Burimi i të dhënave për zërat fiskalë (TVSh, akciza, taksa doganore, tatim fitimi, tatimi mbi biznesin e vogël, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të ardhura tatimore, shpenzimet korrente, shpenzimet për interesat, shpenzimet për papunësinë dhe shpenzimet për ndihmën sociale) është Ministria e Financave. Ndërsa të dhënat lidhur me tregun e punës (paga mesatare në sektorin e prodhimit, paga mesatare në sektorin shtetëror, punësimi sipas sektorëve), IÇK dhe PBB janë marrë nga INSTAT.

Seritë kohore të përdorura janë axhustuar sezonalisht. Ndërsa trendet e serive janë ndërtuar sipas metodës së Hodrick-Prescott duke përdorur koeficientin $\lambda = 480$. Kjo për qëllim se testet e kryera sugjerojnë thyerje strukturore si për punësimin privat ashtu edhe PBB-në tremujore. Nëse bëhej zgjedhja e $\lambda = 1600$ që sugjerohet nga metoda e filtrit HP për seritë me frekuencë tremujore, efekti i thyerjes strukturore do të shpërndahej përgjatë gjithë periudhës, duke bërë që diferenca mes trendit aktual dhe atij të përfutur nga filtri HP të ishte relativisht e lartë. Zgjedhja e vlerës prej 480 për parametrin λ (në vend të 1600) eliminon pjesërisht rezultatet e gabuara mbi komponentin ciklik që vijnë si pasojë e thyerjes strukturore¹⁶.


3.4. HENDEKU I PRODHIMIT (OG)

Për vlerësimin e hendekut të prodhimit, ndryshe nga sa sugjerohet nga metodologjia e OECD-së, i jemi referuar metodës së filtrit Hodrick – Prescott (Hodrick dhe Prescott, 1997), duke qenë se kjo mënyrë është më e thjeshtë për t'u aplikuar nisur nga mangësitë në bazën e të dhënave mbi PBB-në. Ekzistojnë metoda të ndryshme statistikore për të vlerësuar PBB-në potenciale apo hendekun e prodhimit. Metoda e filtrit HP është e thjeshtë dhe nuk kërkon gjykime subjektive ekonomike, ndaj është ndjekur kjo mënyrë

¹⁶ Për detaje lidhur me zgjedhjen e parametrin λ referojuni Bouthevillain. et. al., (2001), ECB WP no.77, f. 23-31.

si më e përshtatshme në llogaritjen e hendekut të prodhimit në rastin e Shqipërisë. Një mënyrë tjetër për të vlerësuar hendekun e prodhimit mund të ishte dhe ajo e funksionit të prodhimit, një metodë e cila ndiqet nga OECD në procesin e llogaritjes së BKC-së. Megjithatë, kjo mënyrë vlerësimi e hendekut të prodhimit kërkon një bazë të gjerë të dhënash lidhur me faktorët e prodhimit, siç janë stoku i kapitalit me çmime konstante, numri total i të punësuarve në ekonomi, si edhe produktiviteti total i faktorëve të prodhimit¹⁷. Gjithsesi, duhet theksuar që metoda e filtrit HP mbart dhe disa probleme lidhur numrin e observimeve të përdorura në seritë kohore, të cilat sugjerohet të jenë mbi 30. Llogaritjet për hendekun e prodhimit në rastin e Shqipërisë bazohen mbi seritë e PBB-së të rregulluara sezonalisht dhe janë përfutur si një kombinim filtrash¹⁸ të ndryshëm e grafiksht paraqitet si më poshtë.

Rezultatet mbi hendekun e prodhimit rrethohen nga pasiguri të larta, për sa kohë prodhimi potencial nuk observohet por vlerësohet nëpërmjet ekuacionit të regresit, duke u kombinuar njëkohësisht me rishikime të shpeshta dhe të konsiderueshme për PBB-në aktuale.



¹⁷ Në rastin e funksionit të prodhimit Cobb-Douglas.

¹⁸ Llogaritjet për PBB-në potenciale marrë nga DPM, Zyra e Parashikimeve.

3.5. LLOGARITJA E ELASTICITETIT TË TË ARDHURAVE TATIMORE

Për të ndërtuar një koeficient i cili vlerëson se si ndikojnë luhatjet në ciklet e biznesit në të ardhurat tatimore shërbejnë 3 nënelasticitete të cilat janë: (i) nënelasticiteti i secilit prej zërave (CIT, PIT, SSC, IT) ndaj bazës makroekonomike; (ii) nënelasticiteti i punësimit ndaj prodhimit; si edhe (iii) nënelasticiteti i fondit të pagave ndaj punësimit. Mënyra e llogaritjes së secilit nënelasticitet për të ardhurat jepet në tabelën 1. Komponenti i parë përfaqëson reagueshmërinë e secilit zë në varësi të bazës makroekonomike respektive (kolona A). Për të gjitha kategoritë e të ardhurave e kemi supozuar këtë elasticitet të barabartë me 1, që do të thotë se rritja e bazës makroekonomike (paga apo fitimet bruto) shoqërohet me rritje të të njëjtës masë të të ardhurave tatimore përkatëse. Një supozim *a priori* i tillë, mundëson që këto elasticitete të mos vlerësohen nëpërmjet regresit. Ndërtimi i ekuacioneve të regresit për të vlerësuar nënelasticitetet sjell devijime të larta të rezultateve për këta koeficientë, në kushtet kur legjislacioni tatimor ka pësuar ndryshime të vazhdueshme në kohë¹⁹. Supozimi i elasticitetit njësi për të ardhurat ndaj bazës respektive makroekonomike është i arsyeshëm, duke qenë se taksat për katër kategoritë që kemi marrë në konsideratë përcaktohen si *ad volarem*²⁰. Në vijim paraqiten më të detajuara supozimet dhe arsyet pas tyre, si edhe llogaritjet e kryera për këtë qëllim.

3.5.1. PËRCAKTIMI I BAZËS MAKROEKONOMIKE

Në hapin e parë, është thelbësor përcaktimi i bazës makroekonomike që i përket çdo zëri buxhetor. Ky hap i rëndësishëm përbën një prej ndryshimeve mes metodologjisë së

¹⁹ Ligjeve për TVSH-në, akcizat dhe për të ardhurat u janë bërë disa amendime dhe ndryshime në një hark kohor disaveççar, të cilat kanë sjellë zgjerim apo reduktim të bazës tatimpaguese (të tilla si: përjashtimet nga TVSh-ja apo heqja e përjashtimeve, ndryshimi i vazhdueshëm i akcizave si edhe shtimi apo ngushtimi i gamës së mallrave të akcizës).

²⁰ Përjashtim bëjnë akcizat dhe taksat doganore, por nga pamundësia për t'i përfshirë saktë të dhënat nga kodi i taksave në një regres, i cili të përcaktojë elasticitetin e gjithsecilës ndaj bazës së vet respektive, i kemi supozuar dhe ato me elasticitet të barabartë me 1.

OECD-së me atë të BQE-së në procesin e vlerësimit të BKC-së. Më konkretisht, metodologjia e OECD-së konsideron si bazë makroekonomike pagat dhe fitimet bruto të kompanive, ndërkohë që BQE përcakton baza të ndryshme makroekonomike për secilin prej 4 zërave të të ardhurave. Për të ardhurat nga taksat indirekte si përfrues i bazës makroekonomike sipas BQE-së shërben konsumi privat, për të ardhurat personale merren punësimi në sektorin privat dhe paga mesatare po në të njëjtin sektor, ndërsa për kontributet sociale merret fondi i pagave për sektorin privat. Metodologjia e BQE-së merr në konsideratë faktin që komponentë të ndryshëm të kërkesës agregate reagojnë ndryshe ndaj një goditjeje në ekonomi, sidomos në afatin e shkurtër. Për shembull, në një rast kur rritja e PBB-së udhëhiqet nga rritja e konsumit privat, të ardhurat nga taksimi indirekt rriten më shumë krahasuar me rastin kur kjo rritje ekonomike vjen si pasojë e rritjes së kërkesës së huaj²¹. Megjithatë, nisur nga kufizimi i të dhënave, në rastin tonë kemi ndjekur metodën e OECD-së. Për shembull, të dhënat për konsumin privat janë të disponueshme vetëm me frekuencë vjetore dhe shtrihen deri në vitin 2008. Gjithashtu, të dhënat për tregun e punës, sidomos ato të pagave në sektorin privat vuajnë problemin e informalitetit, si edhe të mungesës së publikimit të tyre.

3.5.1.1. Nënelasticiteti i të ardhurave personale ndaj bazës makroekonomike

Sikurse u përmend më lart, paga shërben si proxy i bazës makroekonomike për të ardhurat personale. Elasticitetin e të ardhurave personale ndaj pagës e kemi supozuar të barabartë me 1, supozim i cili gjen vend sidomos pas tremujorit të tretë të vitit 2007. Theksojmë se duke filluar nga kjo periudhë tatimi mbi të ardhurat personale nga trajta progresive u kthye në formë proporcionale, prej 10%. Për periudhën para T2 2007, gjatë të cilës tatimi mbi të ardhurat ishte progresiv, nuk është ndërtuar ekuacion regresi për të llogaritur nënelasticitetin e PIT ndaj pagës. Kjo për arsye se ndërtimi i ekuacionit të regresit, sipas metodës së OECD-së, kërkon të dhëna mbi numrin e punonjësve sipas nivelit të pagës, në mënyrë që të llogaritet një normë takse mesatare dhe marxhinale për secilin

²¹ Për detaje referojuni *Bouthevillain. et. al.*, (2001), ECB WP no.77.

interval pagash, të dhëna të cilat nuk disponohen. Gjithsesi, duhet theksuar që në kushtet kur legjislacioni tatimor pëson ndryshime të shpeshta, siç është dhe rasti i Shqipërisë, rezultatet që mund të dalin nga ekuacionet e regresit mund të jenë të gabuara. Përdorimi i variablave *dummy*, të cilët cilësojnë ndryshimet në legjislacionin tatimor, nuk është eficient në këtë rast, për faktin se ndryshimet legjislative kanë qenë të shumta.

3.5.1.2. Nënelasticiteti i sigurimeve sociale ndaj bazës makroekonomike

Për të ardhurat nga sigurimet kemi supozuar gjithashtu pagën si bazë makroekonomike, duke ndjekur kështu të njëjtën logjikë dhe me nënelasticitetin e të ardhurave personale. Mënyra më e mirë që ofron dhe një bazë krahasimi me vendet e tjera është përcaktimi i pagës në sektorin e industrisë si përafëruese e bazës makroekonomike, për arsye se pagat në sektorin publik supozohen të mos jenë ciklike. Elasticitetin e të ardhurave nga sigurimet sociale ndaj pagës e supozojmë 1. Ky supozim gjen mbështetje dhe në ligjin për sigurimet shoqërore e shëndetësore, i cili përcakton një normë prej 27.9% të pagës bruto mujore, sipas listëpagesës, ku pjesa e kontributeve të derdhura në favor të buxhetit të shtetit nga punëdhënësi është 16.7% dhe pjesa e të punësuarit 11.2%²².

3.5.1.3. Nënelasticiteti i tatimit mbi fitimet e bizneseve ndaj bazës makroekonomike

Elasticiteti i tatimit ndaj fitimeve bruto të kompanive supozohet i barabartë me 1, i tillë që ndryshimet ciklike në të ardhurat nga bizneset korrespondojnë me ndryshimet në bazën e taksës, që në këtë rast janë fitimet e kompanive. Një supozim i tillë bazohet në ligjin mbi tatim fitimin, i cili përcakton një normë prej 10%²³ të fitimeve të kompanive si detyrim ligjor për t'u transferuar në buxhetin e shtetit, pa përjashtime ligjore. Fitimet bruto të bizneseve i kemi përafëruar me shumën e zërit të tatimit mbi fitimin me zërin e tatimit të biznesit të vogël të korrektuara për normat korresponduese në

²² Sipas VKM nr. 700, datë 19.06.2009.

²³ Duke filluar nga 1 janari 2008. Para kësaj periudhe, kjo normë ishte 20%.

vite²⁴. Në rastin e Shqipërisë, fitimet e kompanive ndaj PBB-së janë luhatur në një interval vlerash 12-20%. Volatiliteti i lartë i këtij raporti në vite, tregon se fitimet e bizneseve pësojnë luhatje të konsiderueshme gjatë ciklit të biznesit, duke reflektuar në këtë mënyrë luhatje të ngjashme në totalin e të ardhurave të mbledhura nga tatimi mbi bizneset.

3.5.1.4. Nënelasticiteti i të ardhurave nga taksimi indirekt ndaj bazës makroekonomike

Metodologjia e OECD-së sugjeron elasticitetin e të ardhurave nga taksimi indirekt ndaj bazës makroekonomike të barabartë me 1, supozim i cili është ndjekur dhe në rastin tonë. Të ardhurat nga taksimi indirekt formojnë dhe pjesën më të madhe të të ardhurave tatimore, duke zënë mesatarisht rreth 13.2% të PBB-së për periudhën 2008-2011. Logjika e elasticitetit njësi për të ardhurat nga taksimi indirekt funksionon për të ardhurat nga TVSh-ja, ndërkohë që për të ardhurat nga akcizat dhe ato nga taksat doganore nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Kjo për faktin se akcizat përcaktohen në varësi të vëllimit apo njësisë së mallit, dhe jo në përqindje të vlerës së mallit, siç është në rastin e TVSh-së. Bazuar në të dhënat e disponueshme janë bërë përpjekje për të ndërtuar ekuacione regresi për vlerësimin e elasticitetit të të ardhurave nga akcizat dhe nga taksat doganore, por variablat shpjegues kanë dalë statistikisht jo të rëndësishëm. Përdorimi i variablave *dummy* në ekuacionet e regresit për elasticitetin e zërave tatimorë ndaj bazës respektive, nuk ka përmirësuar rezultatet e vlerësimit. Kjo lidhet me faktin se ligji për akcizat e ai për taksat doganore, ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në kuadër të përafrimit të legjislacionit tatimor me atë të EU-së, apo në funksion të respektimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë të mallrave, të nënshkuara me vende të ndryshme. Ndryshimet në bazën legjislative kanë ndikuar konsiderueshëm totalin e të ardhurave tatimore të vjela si gjatë periudhës kur këto ndryshime janë kryer ashtu edhe më vonë.

²⁴ Nëse do të respektonim plotësisht metodologjinë e OECD-së, duhej të llogarisnim fitimet bruto të kompanive, e cila është e vështirë për t'u arritur në kushtet e mungesës së të dhënave të detajuara për kompanitë. Në këtë fazë të studimit, në mungesë të llogaritjeve të sakta për fitimet bruto të kompanive, kemi përdorur ato neto.

3.5.2. ELASTICITETI I PUNËSIMIT NDAJ PRODHIMIT

Nënelasticiteti i dytë, i cili shërben për të identifikuar ndikimin e kushteve ciklike të punësimit mbi të ardhurat nga taksat, nën supozimin e një niveli të caktuar takse për çdo punonjës, është llogaritur ekonometrikisht. Formula standarde e këtij koeficienti paraqitet si më poshtë:

$$\log\left(\frac{L}{L^*}\right) = \beta_1 + \beta_2 \log\left(\frac{Y}{Y^*}\right)$$

Ku, L dhe L^* përfaqësojnë punësimin aktual dhe atë potencial, ndërsa Y dhe Y^* prodhimin aktual dhe atë potencial.

Në rastin e Shqipërisë kemi marrë në konsideratë vetëm punësimin në sektorin privat, duke supozuar që punësimi në sektorin publik nuk ndikohet nga ndryshimet në nivelin e prodhimit. Seritë e përdorura në ekuacion u testuan për praninë e rrënjës njësi. Nga testi i rrënjës njësi ato nuk rezultuan stacionare në nivel, dhe u kthyen të tilla në diferencë të rendit të parë. Ekuacioni i regresit i ndërtuar përfshin si variabla shpjegues: hendekun e prodhimit, hendekun e punësimit në periudhën $t-1$, si edhe termin e mesatares rrëshqitëse. Në ekuacion u përfshi dhe një variabël *dummy* për të kapur ndryshimet në paketën fiskale të vitit 2008, të cilat përcaktuan nivel reference pagash në sektorin privat sipas pozicionit të punës. Pavarësisht faktit se paketa fiskale që hyri në fuqi në vitin 2008 mbartte një sërë masash (krahas atyre me ndikim në tregun e punës), të cilat krijuan efekte të konsiderueshme dhe në akumulimin e të ardhurave tatimore gjatë atij viti buxhetor, variabli *dummy* rezultoi statistikisht i parëndësishëm. Ndërsa variablat e tjerë shpjegues në ekuacionin e regresit rezultuan statistikisht të rëndësishëm me probabilitet ndodhjeje mbi 95%. Statistika DW rezultoi 1.6, ndërsa R^2 ishte 0.3. Ekuacioni së bashku me koeficientët përkatës paraqitet si më poshtë:

$$DLOG(L_{PRIVAT_SA}/L_{PRI_TREND}) = 0.0002 + 0.4025DLOG(Y_{SA}/Y_{SA_POT}) + 0.6604DLOG(L_{PRIVAT}(-1)/L_{PRI_TREND}(-1)) + MA(1)^{25}$$

²⁵ Nëse do të përdornim konceptin e "Koyck transformation", atëherë agregimi i koeficientëve shpjegues do të jepte një parametër të barabartë me 1.18, rezultat i cili nuk ka baza të forta ekonomike. Kështu që kemi preferuar të konsiderojmë vetëm koeficientin $\beta_2=0.4$.

Ku, $L_{\text{PRIVAT_SA}}$ dhe Y_{SA} : përkatësisht, punësimi në sektorin privat dhe PBB reale, rregulluar sezonalisht,

$L_{\text{PRI_TREND}}$: trendi i punësimit privat, vlerësuar ekonometrikisht me filtrin HP,

$Y_{\text{SA_POT}}$: PBB potenciale (vlerësuar nga DPM)

Testet e kryera sinjalizojnë mungesën e korrelacionit serial të mbetjeve, ndërsa shpërndarja e tyre nuk rezulton normale²⁶, e cila mund të lidhet më së shumti me numrin e ulët të observimeve. Bazuar në rezultatet ekonometrike, koeficienti i elasticitetit të punësimit ndaj prodhimit u vlerësua në rreth 0.4, i cili tregon se një ndryshim i prodhimit me 1% sjell një ndryshim të punësimit me rreth 0.4%. Mesatarja e këtij koeficienti për vendet e OECD-së llogaritet në rreth 0.6²⁷. Teorikisht ky parametër merr vlera nën 1, si pasojë e ligjit Okun²⁸, duke qenë se luhatjet në prodhim absorbohen pjesërisht nga ndryshimet në produktivitetin e faktorit punë. Megjithatë, rezultatet e këtij parametri në rastin e Shqipërisë mund të jenë subjekt diskutimi apo rishikimi, për sa kohë që në mungesë të të dhënave apo llogaritjeve për punësimin potencial në sektorin privat, e kemi supozuar të barazvlefshëm me të trendin e punësimit të derivuar nga filtri HP, pavarësisht se ky i fundit konsideron dhe thyerjet strukturore²⁹.

3.5.3. ELASTICITETI I PAGAVE NDAJ PUNËSIMIT

Koeficienti i elasticitetit të pagave ndaj punësimit është një tregues i cili përcakton luhatshmërinë e fondit të pagave për punonjës, në varësi të ndryshimeve në punësim. Noord (2000) sugjeron që ky

²⁶ Breuch-Godfrey serial correlation LM test tregon mungesën e korelacionit serial, sikurse sinjalizohet dhe nga testi Q statistic. Ndërsa testi Jarque Bera tregon se shpërndarja nuk është normale, por kjo lidhet me faktin se numri i observimeve është i ulët, rreth 30.

²⁷ Noord (2000).

²⁸ Ligji Okun përcakton një korrelacion negativ mes ndryshimeve të vërejtura në normën e papunësisë me ndryshimet e PBB-së reale. E thënë ndryshe një rritje në normën e papunësisë duhet të shoqërohet me një normë më të ulët (nga normalja) rritjeje të PBB-së.

²⁹ Shih pjesën "Të dhënat", më lart për detaje lidhur me zgjedhjen e koeficientit λ .

parametër pasqyron efektin e kurbës së Filipsit³⁰ mbi pagat. Bazuar në metodologjinë e sugjeruar nga OECD, ky koeficient ndërtohet sipas ekuacionit:

$$\log \left(\frac{wL^*}{Y^*} \right) = \beta_1 + \beta_2 \log \left(\frac{L}{L^*} \right)$$

Ku, L dhe Y janë të njëjtë me ata të përmendur dhe në llogaritjen e elasticitetit të punësimit ndaj prodhimit, ndërsa w përfaqëson pagën në sektorin privat. Në përpjekjet e kryera për të ndërtuar këtë ekuacion në rastin e Shqipërisë është marrë paga në sektorin e industrisë (duke qenë se mundëson një krahasim dhe me vendet e tjera). Të dhënat e disponueshme për pagën në sektorin e industrisë janë të shprehura në vlerë nominale dhe me frekuencë vjetore (nga INSTAT), të cilat janë kthyer në frekuencë tremujore duke konsideruar që rritja e pagës mesatare në këtë sektor do të ndodhte në tremujorin e tretë të çdo viti përkatës³¹ dhe janë deflatuar me IÇK-në për t'i kthyer në terma realë. Gjithashtu, në ekuacion është përfshirë një variabël *dummy*, për të cilësuar ndryshimet mbi nivelin e pagës që solli miratimi i pagës referencë për të punësuarit në sektorin privat, që hyri në fuqi në janar 2008. Nga ekuacioni i regresit i ndërtuar (i cili kishte një R^2 shumë të ulët prej 0.18 dhe statistikën $DW=1.98$) rezultoi që koeficienti β_2 ishte statistikisht i parëndësishëm (ndërsa variabli *dummy* në këtë ekuacion rezultoi statistikisht i rëndësishëm!). Rezultatet të cilat tregojnë që ndryshimet në punësim nuk shpjegojnë ato në fondin në pagave (nga ekuacioni i ndërtuar) mund t'i atribuohen pjesërisht fleksibilitetit të ulët dhe informalitetit që karakterizon tregun e punës në Shqipëri.

Duke qenë se rezultatet ekonometrike nuk gjeneruan një koeficient statistikisht të rëndësishëm, për të plotësuar kuadrin e indikatorëve të domosdoshëm në vlerësimin e elasticitetit të të ardhurave tatimore është supozuar një koeficient prej 0.5 për elasticitetin e pagave ndaj punësimit, i cili përfaqëson mesataren e vendeve të OECD-së, i llogaritur nga Noord (2000).

³⁰ Kurba e Filipsit, e ndërtuar nga A.W.Phillips në vitin 1958, tregon një lidhje të zhdrejtë mes normës së papunësisë dhe normës së inflacionit të pagave (Macroeconomics, 5th editon, pg. 361 (Mankiw, G.)).

³¹ Ky supozim është kryer për faktin se në tremujorin e tretë të çdo viti qeveria miraton pagën minimale në ekonomi dhe rritja e pagave në sektorin privat ndodh përgjithësisht në të njëjtin tremujor.

3.5.4. REZULTATET PËR ELASTICITETET E TË ARDHURAVE TATIMORE

Duke marrë në konsideratë të gjitha supozimet dhe llogaritjet, elasticitetet e secilit zë të të ardhurave tatimore paraqiten si më poshtë:

Tabelë 1: Derivimi i elasticiteteve të të ardhurave tatimore (sipas Noord, 2000).

	Baza makroekonomike	Elasticiteti ndaj bazës ⁱ	Elasticiteti i punësimit ndaj prodhimit ⁱⁱ	Elasticiteti i pagave ndaj punësimit ⁱⁱⁱ	η_{Ri}	Supozime specifike
kategoria		A	B	C	$D=B(1+A*C)^{iv}$	E
PIT	Paga	1	0.4	0.5	0.6	
SSC	Paga	1	0.4	0.5	0.6	
					$D=\{1-(1-E)*B*(1+C)\}/E$	
CIT	Fitimet e kompanive	1	0.4	0.5	2.8	Fitim/PBB=19%

ⁱ: supozuar i barabartë me 1.

ⁱⁱ: vlerësuar ekonometrikisht.

ⁱⁱⁱ: është marrë mesatare e vendeve të OECD-së (2000).

^{iv}: llogaritja e secilit prej koeficientëve është bërë sipas formulave të prezantuara nga Noord (2000).

Elasticiteti i të ardhurave nga taksat indirekte ndaj hendekut të prodhimit supozohet i barabartë me 1, sikurse e sugjeron dhe metodologjia e OECD-së. Një supozim i tillë, është si një zgjedhje e dytë më e mirë, për sa kohë rezultatet ekonometrike mund të japin rezultate të gabuara, pasi vuajnë nga probleme që lidhen si me gjatësinë e serive të disponueshme, ashtu edhe me mungesën e informacionit mbi bazën legjislativë për kohën e marrjes së secilës prej masave fiskale me impakt në sistemin e taksave. Ndërsa vlera mesatare e elasticitetit të llogaritur nga Noord (2000) për vendet e OECD për PIT, SSC dhe CIT është respektivisht 1, 0.8 dhe 1.3.

Krahas mënyrës së prezantuar nga Noord (2000), kemi aplikuar dhe atë të propozuar nga Andrè dhe Girouard (2005) për të llogaritur elasticitetet e zërave tatimorë. Në ndryshim nga Noord (2000), ata i vlerësojnë elasticitetet e secilit zë të të ardhurave tatimore bazuar në dy komponentë përbërës, e që janë: (i) elasticiteti i secilit zë tatimor ndaj bazës makroekonomike, dhe (ii) elasticiteti i bazës makroekonomike ndaj treguesve ciklikë. Për komponentin e parë është ndjekur e njëjta logjikë si në rastin e llogaritjes së elasticiteteve sipas Noord,

duke e supozuar nënelasticitet njësi për secilin zë tatimor ndaj bazës makroekonomike (gjithashtu si për afrues të bazës makroekonomike kemi supozuar pagën në sektorin privat), nën të njëjtat supozime dhe arsyetime si më lart. Ndërsa për nënelasticitetin e dytë (atë të fondit të pagave ndaj hendekut të prodhimit), në mungesë të rezultateve ekonometrike të sakta e në përputhje me ligjësinë ekonomike, kemi marrë në konsideratë mesataren e llogaritur për vendet e OECD-së në nëngrupin e 6 dhe të 7³². Bazuar në këto supozime, llogaritja e elasticiteteve të të ardhurave tatimore paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën 2, si më poshtë:

Tabelë 2: Derivimi i elasticiteteve të të ardhurave tatimore (sipas metodës së André dhe Girouard, 2005).

	Baza makroekonomike	Elasticiteti ndaj bazës ⁱ	Elasticiteti i fondit të pagave ndaj hendekut të prodhimit ⁱⁱⁱ	η_{Ri}	Supozime specifike
kategoria		A	B	C=A*B	D
PIT	Paga	1	0.8	0.8	
SSC	Paga	1	0.8	0.8	
				C={1-(1-D)*B}/D	
CIT	Fitimet e kompanive	1	0.8	1.8	Fitime/ PBB=19%

ⁱ: supozuar i barabartë me 1.

ⁱⁱ: vlerësuar ekonometrikisht.

ⁱⁱⁱ: mesatare e vendeve të nëngrupeve 6 dhe 7 të OECD-së (2005).

Duke respektuar formulat e paraqitura në secilën prej tabelave (1 dhe 2) për elasticitetin e secilit zë tatimor ndaj hendekut të prodhimit, nëpërmjet formulës $\eta_R = \sum_{i=1}^d \eta_{R,i} \frac{R_i}{R}$, derivojmë elasticitetin e të ardhurave tatimore, i cili ka rezultat pothuajse i njëjtë sipas dy mënyrave (0.91 dhe 0.92). Pesha e secilit zë tatimor në totalin e të ardhurave tatimore përfaqëson një mesatare të thjeshtë të periudhës 2008-2011³³. Rezultatet e përmbledhura për elasticitetet e vlerësuara të të ardhurave tatimore ndaj hendekut të prodhimit në rastin e Shqipërisë, sipas të dyja metodave paraqiten në tabelën 3 si më poshtë:

³² Sipas OECD-së (2005) në nëngrupin 6 janë klasifikuar Republika Çeke, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia. Ndërsa në atë të 7 përfshihen Spanja, Greqia dhe Portugalia.

³³ Nuk kemi konsideruar në llogaritjen e mesatares së peshave periudhën para vitit 2008, për faktin se paketa fiskale e këtij viti, solli ndryshime të konsiderueshme dhe në akumulimin e të ardhurave buxhetore nga periudhat e mëparshme.

Tabelë 3: Elasticiteti i të ardhurave tatimore, përmbledhje rezultatesh.

	Andrè&Girouard	Noord	Pesha ($\frac{R_t}{R}$)	Mes. OECD (2000)	Mes. OECD (2005)
η_{PIT}	0.81	0.59	0.09	1.0	1.3
η_{SSC}	0.81	0.59	0.18	0.8	0.7
η_{CIT}	1.84	2.81	0.07	1.3	1.5
η_{IT}	1.00	1.00	0.56	0.9	1.0
η_R	0.91	0.92			

Ndërsa parametri i sensitivitetit të të ardhurave tatimore ndaj hendekut të prodhimit $\varepsilon_R = \eta_{R/Y}$ rezultojnë i njëjtë me të dyja mënyrat, 0.22, duke konsideruar një mesatare të thjeshtë të raportit të të ardhurave tatimore ndaj PBB-së nominale për periudhën 2008-2011 ($R/Y = 23.7\%$).

3.6 LLOGARITJA E ELASTICITETIT TË SHPENZIMEVE KORRENTE PRIMARE

Koeficienti i elasticitetit të shpenzimeve reflekton ndryshimet në nivelin e shpenzimeve të lidhura me papunësinë në varësi të cikleve të biznesit. Elasticiteti i shpenzimeve korrente primare, llogaritet si produkt i elasticitetit të shpenzimeve për papunësinë ndaj hendekut të prodhimit, me peshën e këtij zëri në totalin e shpenzimeve korrente primare ($\eta_G = \eta_{G,U} \frac{G_U}{G}$). Sikurse sugjeron dhe metodologjia e OECD-së, është supozuar elasticitetin njësi i shpenzimeve për papunësinë ndaj bazës makroekonomike (si proxy në këtë rast shërben papunësia). Në të njëjtën kohë, edhe pagesa e papunësisë për çdo të papunë supozohet e pandjeshme ndaj kushteve ciklike në ekonomi.

Për vlerësimin e elasticitetit të shpenzimeve korrente primare, i cili jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelën 4, kemi supozuar që oferta për punë nuk reagon ndaj luhatjeve në punësim. Ndërsa për normën e papunësisë ekuilibër në afat të gjatë (NAIRU³⁴) kemi marrë 2 vlera, një që i korrespondon periudhës 2005-2008 dhe tjetra periudhës 2009-2011. Kjo për arsye se ekonomia shqiptare vlerësohet të ketë pësuar një ndryshim strukturor pikërisht në fund të

³⁴ NAIRU përkufizohet si norma e papunësisë ekuilibër në afat të gjatë, në kushtet kur inflacioni është konstant, i cili arrihet në rastin kur plotësohen pritjet e punëdhënësve për çmimet, si edhe pritjet e punëmarrësve për pagat (OECD, 1997).

viti 2008 dhe gjatë vitit 2009³⁵. Metodologjia e OECD-së sugjeron përdorimin e NAWRU³⁶ në llogaritjen e elasticitetit të shpenzimeve ndaj prodhimit. Në mungesë të vlerësimeve për NAWRU kemi përdorur NAIRU, duke qenë se janë koncepte pak a shumë të ngjashme. Në të njëjtën kohë, NAIRU merr në konsideratë pritjet jo vetëm për pagat, por edhe për çmimet³⁷. Elasticiteti i shpenzimeve për papunësinë ndaj prodhimit, $\eta_{G,U}$, për periudhën 2005-2008 vlerësohet në rreth -2.5, ndërsa për periudhën e dytë (2009-2011) në rreth -2.6. Nëse llogaritjet për këtë tregues janë të sakta, një vlerë e tillë për këtë indikator tregon që një rritje e prodhimit me 1%, sjell një reduktim të shpenzimeve për papunësinë me 2.6% (2.5%). Duke përdorur një mesatare të peshës së shpenzimeve të lidhura me papunësinë në shpenzimet korrente primare, llogarisim një koeficient $\eta_G = -0.2$. Duhet theksuar se në momentin që vlerat e ndryshme për $\eta_{G,U}$ përfshihen në llogaritjen e η_G rezultatet për këtë koeficient konvergojnë në -0.17 për të dyja rastet.

Tabelë 4: Elasticiteti i shpenzimeve buxhetore ndaj prodhimit.

	Elasticiteti i punësimit ndaj prodhimit	Elasticiteti i ofertës së punës ndaj punësimit	NAIRU / NAWRU	G_u/G	$\eta_{G,U}$	η_G
	A	B	C	D	$E = -A * \{(1 - B)/C - 1\}$	$F = D * E$
Shqipëri	0.4 ⁱⁱ	0.0 ⁱⁱⁱ	13% ^{iv}	7% ^v	-2.6	-0.2
Mesatare OECD ⁱ	0.6	0.3	9%	7%	-4.3	-0.3 ^{vi}

ⁱ: sipas Noord (2000)

ⁱⁱ: vlerësuar ekonometrikisht.

ⁱⁱⁱ: supozuar 0.

^{iv}: NAIRU për rastin e Shqipërisë nga Dushku E. dhe Kota V. (2011). Vlera në tabelë, mesatarja e periudhës 2009-2011.

^v: pesha mesatare e shpenzimeve të lidhura me papunësinë në totalin e shpenzimeve korrente primare për periudhën 2008-2011.

^{vi}: mesatarja e η_G për vendet e OECD-së e vlerësuar në vitin 2000 është -0.3, ndërsa ajo e rishikuar në vitin 2005 është -0.1. Ky ndryshim lidhet më së shumti me rishikimin e kategorive të shpenzimeve të lidhura me papunësinë. Kështu në vitin 2005, u reduktua numri i zërave të konsideruar si të lidhur me papunësinë, duke bërë që pesha e tyre në shpenzimet korrente primare të ishte më e ulët nga ajo e vitit 2000.

³⁵ Pas frenimit të ritmeve të larta të rritjes ekonomike të vërejtura deri në vitin 2008, ekonomia gjykohej të ketë hyrë në një fazë të re strukturimi gjatë periudhës 2009-2011, kryesisht si pasojë e shkurtimeve të vendeve të punës.

³⁶ NAWRU mat papunësinë strukturore duke lidhur papunësinë me inflacionin e pagave (OECD, 1997).

³⁷ Vlerësimet për NAIRU janë kryer nga Dushku dhe Kota (2007).

Ndërkohë, parametri i sensitivitetit të shpenzimeve korrente primare, ε_G vlerësohet në rreth -0.04, (sipas formulës), duke marrë si përfaqësues raportin mesatar të shpenzimeve korrente primare ndaj PBB-së (prej 21%) për periudhën 2008-2011.

3.7 SENSITIVITETI BUXHETOR

Rezultatet për η_R (0.9) dhe η_G (-0.2) të përftuara në rastin e Shqipërisë janë pak a shumë të ngjashme me ato që sugjeron literatura ekonomike³⁸ dhe të përafërta me studime të tjera të kryera për rastin e Shqipërisë³⁹. Parametri i sensitivitetit buxhetor $\varepsilon = \varepsilon_R - \varepsilon_G$, rezulton rreth 0.26. Në tabelën 5 jepet një krahasim i rezultateve të Shqipërisë me ato të disa prej vendeve të Evropës Juglindore.

Tabelë 5: Parametrat e sensitivitetit buxhetor.

	ε_R	ε_G	ε
Bullgari (BG)	0.35	-0.01	0.36
Çeki (CZ)	0.36	-0.01	0.37
Greqi (EL)	0.42	-0.01	0.43
Spanjë (ES)	0.38	-0.05	0.43
Itali (IT)	0.49	-0.02	0.51
Hungari (HU)	0.45	-0.01	0.46
Poloni (PL)	0.33	-0.06	0.39
Rumani (RO)	0.28	-0.02	0.30
Sloveni (SI)	0.42	-0.05	0.47
Slovaki (SK)	0.27	-0.02	0.29
Shqipëri (AL)	0.22	-0.04	0.26
BE 27	0.39	-0.04	0.43

Burimi: EC. DG ECFIN, 2005; dhe llogaritje të autores për Shqipërinë.

Siç vërehet nga tabela krahasuese, parametri i sensitivitetit buxhetor për Shqipërinë është i krahasueshëm me nivelet e vlerësuara për vende si Sllovakia dhe Rumania, por gjithsesi më i ulëti krahasuar me vendet e tjera të marra në konsideratë. Vlera relativisht e ulët për ε shpjegohet nga raportet e ulëta të të ardhurave tatimore ndaj PBB-së, si edhe nga madhësia e moderuar e sektorit publik në rastin e Shqipërisë.

³⁸ Shih Fedelino et.al. (2009), Bouthevillain. et. al., (2001), Girouard and André (2005).

³⁹ Rezultatet janë të krahasueshme dhe me Mançellari (2009), e cila nëpërmjet një modeli SVAR ka vlerësuar një elasticitet të të ardhurave prej 0.96, dhe për shpenzimet -0.15.

Megjithatë duhet theksuar se llogaritjet për koeficientin e elasticitetit buxhetor janë të rrethuara nga disa paqartësi. Së pari, ato bazohen në ekuacione regresi për seritë kohore të kombinuara me informacione nga legjislacioni tatimor në fuqi. Në këtë aspekt, treguesi i sensitivitetit buxhetor reflekton një reagueshmëri në terma mesatarë të të gjithë zërave buxhetorë të ndjeshëm ndaj luhatjeve ciklike për të gjithë periudhën e marrë në konsideratë. Sjellja e tyre nga viti në vit mund të jetë e ndryshme, për sa kohë lloje të ndryshme taksash reagojnë ndryshe përgjatë një cikli biznesi. Së dyti, sjellja ciklike e të ardhurave tatimore mund të ketë ndryshuar në përgjigje të reformave të shumta të ndërmarra në sistemin tatimor përgjatë periudhës 2005-2012. Së treti, ecuria e të ardhurave tatimore përcaktohet deri diku dhe nga natyra e goditjes së marrë nga ekonomia (një goditje nga krahu i kërkesës që buron nga disbalancat e jashtme, nuk ka të njëjtin impakt mbi të ardhurat tatimore sikurse një goditje që mund të vijë nga një ndryshim i qenësishëm në sjelljen e konsumatorit).

4. BKC DHE POLITIKA FISKALE


Bazuar në rezultatet e përfutuara nga metodologjia e ndjekur, fillimisht ofrohet një tablo e përgjithshme mbi natyrën e politikës fiskale për periudhën e analizuar në Shqipëri, për të vijuar më tej me një analizë të shkurtër krahasuese të pozicioneve fiskale dhe madhësisë së korrektimit fiskal të vendeve të Evropës Juglindore për vitin 2012. Gjithsesi, duhet theksuar se saktësia e rezultateve kushtëzohet nga disa aspekte. Së pari, ato janë objekt diskutimi në varësi të llogaritjes së saktë të elasticiteteve të të ardhurave tatimore dhe shpenzimeve buxhetore. Dhe në fakt, këta parametra mund të jenë të diskutueshëm apo mund të kenë nevojë për rishikim, për sa kohë ato mbartin dhe efekte që mund të vijnë nga thyerjet strukturore në ekonomi. Në të njëjtën kohë, procesi i llogaritjes së elasticiteteve, sikurse u trajtua më lart, është mbështetur në një numër të konsiderueshëm supozimesh, të cilat ndonëse në momentin e përgatitjes së këtij materiali janë zgjedhja e dytë më e mirë, mund të kushtëzojnë saktësinë e rezultateve për këta tregues. Së dyti, sikurse sugjeron dhe literatura ekonomike pavarësisht metodës së ndjekur, vlerësimet për hendekun e prodhimit mund të mbartin gabime të konsiderueshme, sidomos drejt fundit të periudhës së marrë në analizë. Gjithashtu, një marzh të shtuar devijimi për BKC-në në rastin tonë sjell dhe moskorrektimi i saj për masat me karakter të përkohshëm, të cilat kanë qenë pjesë e të ardhurave buxhetore përgjatë periudhës së marrë në analizë. Këto të ardhura kanë qenë si në formën e të ardhurave nga privatizimet, nga licencat e ndryshme (siç ishte ajo e shërbimit 3G për kompanitë që operojnë në sektorin e telekomunikacionit), apo dhe nga amnistia fiskale e vitit 2011. Evidentimi i këtyre masave si edhe korrektimi i BKC-së për efektin e tyre do të jenë subjekt i punës së ardhshme.

4.1 TABLOJA FISKALE BAZUAR NË VLERËSIMET PËR BKC

Nga rezultatet e përfutuara për BKC-në, tabloja fiskale ndër vite nuk paraqitet e njëjtë referuar vlerave nominale për deficitin buxhetor dhe atyre të korrektuara për ciklet e biznesit. Komponenti ciklik i balancës buxhetore krahas magnitudës, ka regjistruar dhe kahe

të ndryshme gjatë viteve të marra në analizë (grafik 2, djathtas). Kjo do të thotë që për vite të caktuara, komponenti diskrecionar i politikës fiskale i matur nëpërmjet vlerave nominale të treguesve buxhetorë mund të jetë mbivlerësuar, ashtu sikurse dhe e kundërta. Për ta ilustruar do të marrim në konsideratë 2 vite të ndryshme, përgjatë të cilëve komponenti ciklik i balancës buxhetore krahas madhësisë së ndryshme, ka shënuar dhe kahe të kundërta.

Rasti i parë është ai i vitit 2008, në fund të të cilit deficiti buxhetor në terma të PBB-së rezultoi rreth 5.5%. Ndërkohë, deficiti buxhetor që reflekton politikën fiskale diskrecionare të ndjekur gjatë këtij viti vlerësohet në rreth 6% të PBB-së. Rezultatet për BKC-në tregojnë se pozicioni fiskal në vitin 2008 është përmirësuar me 0.5 pikë përqindje, si pasojë e një hendeku pozitiv të prodhimit.



Rast të kundërt me vitin 2008 përbën viti 2012, në fund të të cilit komponenti ciklik i balancës buxhetore vlerësohet të jetë negativ. Vlera negative e këtij komponenti (0.2 pikë përqindje) interpretohet si një përkeqësim i deficitit të përgjithshëm buxhetor në të njëjtën masë, si pasojë e kushteve ciklike përgjatë këtij viti. E thënë ndryshe, nën supozimin që për vitin 2012 deficiti i planifikuar prej 3% të PBB-së do të respektohet, 92% e tij do të formohet në përgjigje të politikës fiskale diskrecionare, ndërsa pjesa e mbetur do t'i atribuohet faktorëve të përkohshëm që vijnë nga luhatjet ciklike.

4.2 BKC DHE STABILIZATORËT AUTOMATIKË

Politika fiskale ka një rol të lartë në stabilizimin e ekonomisë përgjatë një cikli biznesi. Megjithatë, politika fiskale diskrecionare kërkon një kohë më të gjatë për të vepruar dhe nuk reagon menjëherë në përgjigje të kushteve ekonomike të ndryshuara. Ndryshe nga komponenti diskrecionar i politikës fiskale, stabilizatorët automatikë veprojnë pa vonesa kohore dhe përfaqësojnë reagimin fiskal vetëkorrektues (FMN, 2009). Pavarësisht faktit se ekziston një gamë mjaft e gjerë literature ekonomike me fokus stabilizatorët automatikë, debati akademik ashtu si dhe ai politik nxjerrin në pah mungesën e një koncepti të qartë mbi përkufizimin e stabilizatorëve automatikë, si edhe vlerësimin të efektivitetit të tyre në drejtim të zbutjes së luhatjeve në nivelin e prodhimit⁴⁰. Masa e ndikimit të stabilizatorëve automatikë mbi deficitin buxhetor përcaktohet kryesisht nga legjislativi tatimor si edhe sistemi i sigurimeve sociale, dhe nuk kërkon ndërhyrjen e autoritetit fiskal.

Literatura ekonomike nuk ofron një konsensus lidhur me vlerësimin e madhësisë së stabilizatorëve automatikë⁴¹. Disa ekonomistë për vlerësimin e madhësisë së stabilizatorëve automatikë favorizojnë si përafresues madhësinë e sektorit publik, të shprehur në terma të shpenzimeve buxhetore ndaj PBB-së. Të tjerë, ndër ta dhe Mohanty dhe Scatigna (2003) njehsojnë me stabilizatorët automatikë komponentin ciklik të balancës buxhetore. Sipas këtij përkufizimi, stabilizatorët automatikë në rastin e Shqipërisë ilustrohen nëpërmjet grafikut 2 djathtas. Ndryshe nga dy pikëpamjet e mësipërme, në këtë material stabilizatorët automatikë janë përafëruar me ndryshimet në komponentin ciklik të balancës buxhetore, sipas sugjerimeve të Cottarelli dhe Fedelino (2010).


Rikujtojmë ekuacionin e balancës buxhetore ndaj PBB-së,

$$BB = BKC + KC$$

ku, KC përfaqëson komponentin ciklik të balancës buxhetore. Madhësia e stabilizatorëve automatikë, e llogaritur si $AS = \Delta KC = KC_t - KC_{t-1}$ në rastin e Shqipërisë paraqitet në grafikun 3 si më poshtë.

⁴⁰ Për detaje shih in't Veld, et al. (2012).

⁴¹ Shih Cottarelli dhe Fedelino (2010).



Bazuar në rezultatet për BKC-në, madhësia e stabilizatorëve automatikë në rastin tonë paraqitet e moderuar. Vlerësimet e ulëta për stabilizatorët automatikë mund të jenë pasojë e: (i) madhësisë së moderuar të sektorit publik (e shprehur si raport i shpenzimeve publike ndaj PBB-së); (ii) strukturës së taksave, e cila përcakton një nivel të ulët të të ardhurave me karakter tatimor ndaj PBB-së; (iii) normës fikse të tatimit të përcaktuar mbi të ardhurat personale, përkundrajt asaj progresive⁴²; si edhe (iv) luhatjeve relativisht të moderuara të vlerësuar për hendekun e prodhimit.

Evidentimi i veprimit dhe i madhësisë së stabilizatorëve automatikë kanë një rëndësi të lartë për autoritetin monetar. Kjo për faktin se stabilizatorët automatikë janë të një natyre të përkohshme dhe kanë shumë pak gjasa të ndikojnë negativisht në pritjet e agjentëve (për shembull, për normën e interesit). Megjithatë, gjykojmë se në rastin tonë madhësia e stabilizatorëve automatikë dhe efektiviteti i tyre kushtëzohet në mënyrë të konsiderueshme nga niveli i ulët i të ardhurave tatimore në raport me PBB-në (rreth 24%), e cila dikton një reagueshmëri të dobët të të ardhurave tatimore ndaj një goditjeje të mundshme në ekonomi që vjen nga kahu i kërkesës.

⁴² Baunsgaard dhe Symansky (2009) kanë vlerësuar se si përkthehet rritja e progresivitetit të taksës mbi të ardhurat personale në rritjen e stabilizatorëve automatikë për 26 vende të OECD-së.


4.3 NATYRA E POLITIKËS FISKALE

Sipas literaturës ekonomike ekzistojnë tre përkufizime të natyrës së politikës fiskale që lidhen me zhvillimet ekonomike në vend, të cilat sipas radhës janë politikë fiskale prociklike, politikë fiskale kundërciklike dhe politikë fiskale neutrale. Në periudha kur ekonomia përjeton një rritje ekonomike mbi potencialin e saj, rritja e shpenzimeve buxhetore me ritme më të larta se të ardhurat, ndikojnë në rritjen e raportit të deficitit ndaj PBB-së, duke sugjeruar në këtë mënyrë politikë fiskale prociklike. Ndërsa, “në kohë të këqija”, kur rritja ekonomike rezulton nën potencial, natyra prociklike e politikës fiskale reflektohet në reduktim të raportit të shpenzimeve publike ndaj PBB-së, duke sjellë gjithashtu dhe një rënie të deficitit buxhetor të shprehur në raport me PBB-në. Gavin dhe Perotti (1997), argumentojnë se natyra prociklike e politikës fiskale në “kohë të këqija”, ndër të tjera shpjegohet me mundësitë e kufizuara për kredimarrje të sektorit publik. Ky është një tipar që karakterizon sidomos ekonomitë e vendeve në zhvillim, të cilat gjatë këtyre periudhave nuk mund të marrin hua për të financuar shpenzimet e tyre ose mund të marrin hua vetëm në terma interesi mjaft të larta. Përballë këtyre kushteve, autoriteti fiskal detyrohet të reduktojë deficitin buxhetor, nëpërmjet uljes së shpenzimeve publike. Ndërsa Alesina dhe Tabellini (2005), natyrën prociklike të politikës fiskale e lidhin me sistemin politik në vend, duke evidentuar një korrelacion mjaft të lartë mes prociklitit të politikës fiskale me nivelin e korrupsionit në vend.

Politika fiskale konsiderohet të jetë kundërciklike kur deficieti buxhetor thellohet në kushtet e një rritjeje ekonomike nën potencialin e saj, si pasojë e stimujve fiskalë të ndërmarrë nga qeveria në kuadër të gjallërimit të ekonomisë. Natyra kundërciklike e politikës fiskale vërehet dhe në praninë e një hendeku pozitiv të prodhimit, duke u faktorizuar në raport më të ulët të deficitit buxhetor ndaj PBB-së. Ndërsa me politikë fiskale neutrale përshkruhet situata kur BKC mbetet e pandryshuar gjatë ciklit të biznesit, ndërkohë që stabilizatorët automatikë veprojnë lirshëm në ekonomi (KE, 2009).

Për të vlerësuar natyrën e politikës fiskale gjatë periudhës 2006-2012 shërben grafiku 4, ku janë paraqitur ndryshimet në BKC

(boshti vertikal) në varësi të kushteve ciklike në ekonomi (boshti horizontal)⁴³. Pjesa e sipërme e grafikut 4 tregon përmirësim të BKC-së, ndërsa dy kuadrantet e pozicionuara poshtë boshtit horizontal ilustron përqendrim të pozicionit fiskal. Pjesa djathtas e grafikut i referohet kushteve ciklike të përmirësuara, ndërsa ajo majtas ilustron “kohët e këqija”, kur hendeku i prodhimit është negativ. Vlerësimet mbi BKC-në në rastin e Shqipërisë, ndonëse në kundërshti me argumentet normative, sugjerojnë se episodet e politikës fiskale prociklike kanë qenë të shumta. Natyra prociklike e politikës fiskale diskrecionare është hasur si në periudha kur rritja ekonomike ka rezultuar mbi potencialin e saj (viti 2008 e 2009), ashtu edhe në “kohët e këqija”, kur në kushtet e një hendeku negativ të prodhimit, BKC është përmirësuar (vitet 2006, 2010 e 2012). E thënë ndryshe, karakteri prociklik i politikës fiskale është manifestuar jo vetëm në kahun lehtësues të saj (vitet 2008 e 2009), por edhe në atë shtrëngues (2006, 2010 e 2012).



Referuar rezultateve që na ofron llogaritja e BKC-së në rastin e Shqipërisë, nuk kanë munguar dhe rastet kur politika fiskale është shfaqur me nota kundërciklike, siç mund të përmendim vitet 2007 dhe 2011, kur në praninë e një hendeku negativ të prodhimit, BKC në terma vjetorë është përqendësuar. Vlerësimet për BKC-në tregojnë

⁴³ Në vend të deficitit buxhetor kemi marrë në konsideratë BKC-në për të vlerësuar natyrën e politikës fiskale në rastin e Shqipërisë.

se karakteri kundërciklik i politikës fiskale është hasur vetëm në rastet kur ajo ka rezultuar në kahun lehtësues. Sipas argumenteve të Fatas dhe Mihov (2009), dhe në rastet kur politika fiskale është kundërciklike, ajo është më pak e tillë nga ç'sugjerojnë modelet normative. Megjithatë, në këtë fazë studimi nuk është testuar nëse këto argumente janë vërtetuar plotësisht në rastin e Shqipërisë, kur politika fiskale ka shfaqur natyrë kundërciklike.

Referuar literaturës ekonomike, politika fiskale prociklike nuk është e dëshirueshme sidomos për autoritetin monetar, nëse ky i fundit ka në objektivat e tij dhe reduktimin e luhatjeve në nivelin e prodhimit. Kjo për arsye se për të zbutur luhatjet në kërkesën agregate është e nevojshme një ndërhyrje më agresive e bankës qendrore, e cila nga ana tjetër sjell për pasojë luhatshmëri të lartë të normave të interesit në treg, duke ngritur në këtë mënyrë pikëpyetje mbi efektivitetin e politikës monetare. Megjithatë, ka dhe ekonomistë që mbrojnë tezën se procikliteti i politikës fiskale nuk duhet parë me skepticizëm, për sa kohë ai redukton vulnerabilitetet fiskale afatgjata dhe përmirëson besimin në tregjet financiare.

Tipari prociklik i politikës fiskale gjatë periudhës së analizuar vërtetohet dhe empirikisht nëpërmjet një ekuacioni të thjeshtë të ndërtuar për BKC-në. Regresi i ndërtuar është një formë "e ndërmjetme"⁴⁴ e asaj të sugjeruar nga Fatas dhe Mihov (2009) me atë të Debrun dhe Kapoor (2010). Ky ekuacion përpiqet të kuantifikojë dimensionet ciklike (parametri β_2) dhe ato diskrecionare të politikës fiskale (parametri β_3), dhe ka formën e:

$$BKC_t = \beta_1 + \beta_2 OG_{t-1} + \beta_3 D_{t-1} + \varepsilon$$

Ku,

D_{t-1} përfaqëson stokun e borxhit publik një vit më parë,


OG_{t-1} : hendeku i prodhimit një vit më parë.

ε : termi i gabimit

⁴⁴ Ndryshe nga autorët e përmendur, kemi supozuar që ndryshimet ciklike të veprojnë me një kohëvonesë. Debrun dhe Kapoor (2010) konsiderojnë BKC_{t-1} , si variablin e dytë shpjegues për BKC_t . Ndërsa Fatas dhe Mihov (2009) krahas variablave shpjegues të përdorur nga Debrun dhe Kapoor konsiderojnë dhe D_{t-1} .

Logjika e këtij regresi të thjeshtë sugjeron se politika fiskale hartohet në funksion të nivelit të borxhit (parametri β_3) dhe kushteve ciklike (reflektuar nëpërmjet koeficientit β_2). Ashtu siç pritej, parametri β_2 rezultoi negativ, çka tregon që rikuperimi (ngadalësimi) ekonomik sjell një përkeqësim (përmirësim) të BKC-së, duke dëshmuar në këtë mënyrë praninë e një politike fiskale prociklike. Në këtë fazë të studimit nuk janë bërë përpjekje për të kuantifikuar dimensionin prociklik të politikës fiskale dhe jemi mjaftuar vetëm me evidentimin e shenjës së parametrin β_2 , i cili mat reagimin afatshkurtër të BKC-së ndaj hendekut të prodhimit.

Krahas një vlerësimi për natyrën e politikës fiskale, llogaritjet për BKC-në na mundësojnë të evidentojmë dhe proceset e konsolidimit fiskal përgjatë periudhës së analizuar. Bazuar në përkufizimin mbi fazat e një procesi të konsolidimit fiskal (sipas KE, 2009)⁴⁵, rezulton vetëm një i tillë përgjatë periudhës së analizuar. Kështu, në vitin 2010 është regjistruar një korrektim i konsiderueshëm i financave publike, i materializuar në një përmirësim të BKC-së me rreth 4.2 pikë përqindje nga një vit më parë. Ky konsolidim fiskal i vërejtur gjatë këtij viti është mbështetur kryesisht në reduktimin e shpenzimeve për investime, të cilat në vitet 2008 dhe 2009 kanë shënuar vlerat më të larta historike⁴⁶.



⁴⁵ Detajet mbi përkufizimin e fillimit, vazhdimësisë dhe përfundimit të procesit të konsolidimit fiskal, *European Economy*, 2009 "Achieving and safeguarding sound fiscal positions", f.62.

⁴⁶ Shpenzimet kapitale në vitet 2008 e 2009 janë rritur me rreth 2.5 pp të PBB-së, nga mesatarja e tyre historike si pasojë e shpenzimeve për rrugën Durrës-Kukës.

Në vitin 2012 gjithashtu vërehet fillimi i një tjetër procesi konsolidimi fiskal, vijimësia e të cilit kushtëzohet në një masë të madhe nga sjellja e autoritetit fiskal për vitin 2013⁴⁷.

4.4 SITUATA FISKALE NË 2012: KRAHASIM ME VENDET E EVROPËS JUGLINDORE


Kriza globale, e cila i pati fillimet në shtator 2008, bëri të domosdoshme ndërhyrjen e autoriteteve monetare e fiskale për të kufizuar pasojat që mund të përcilleshin në sektorin real. Borxhet publike të shumë vendeve janë rritur në mënyrë të paprecedentë në përpjekje për të shpëtuar ekonomitë e rrezikuara dhe për të rikthyer besimin e lëkundur në tregjet financiare. Në fund të vitit 2012, borxhi publik për zonën euro vlerësohet mesatarisht 88% e PBB-së, një raport ky rreth 20 pikë përqindje më i lartë nga niveli i shënuar përpara fillimit të krizës globale (KE, 2012). Rritja e borxhit publik krahas vlerave të larta për deficitet buxhetore, ndërhyrjeve të vazhdueshme në tregjet financiare është shkaktuar dhe nga nivelet modeste që ka shënuar rritja reale ekonomike përgjatë kësaj periudhe.

Përkeqësimi i pozicioneve fiskale në vendet e Evropës Juglindore dhe më gjerë, ka shtuar shqetësimet rreth qëndrueshmërisë së financave publike, duke vënë theksin mbi domosdoshmërinë e marrjes së hapave të nevojshëm në drejtim të konsolidimit fiskal. Ndonëse në periudhë afatshkurtër konsolidimi fiskal mund të shkaktojë tkurrjen e kërkesës agregate, në terma afatgjatë ai i shërben rritjes ekonomike, nëpërmjet reduktimit në primet e rrezikut. Kumar et. al (2007) sugjerojnë se konsolidimet fiskale që kanë synuar reduktimin e shpenzimeve korrente në vend të shpenzimeve kapitale, kanë rezultuar më të suksesshme.

Situata fiskale për vitin 2012 në vija të përgjithshme paraqitet pak a shumë e ngjashme në të gjitha vendet e Evropës Juglindore, përfshirë dhe Shqipërinë. Kështu, përmirësimi i BKC-së nga një vit më parë i kombinuar me hendek negativ të prodhimit ka bërë

⁴⁷ Bazuar në projektbuxhetin për vitin 2013, deficitet buxhetor i planifikuar (për vitin 2013) është më i lartë nga ai i pritur për 2012-ën.

që politika fiskale të jetë e karakterit prociklik për të gjitha vendet (përjashtuar Hungarinë).



Përpjekjet për korrektimin e financave publike në shumë vende të Evropës Juglindore kanë nisur në vitin 2010, e për një pjesë të tyre në 2011-ën. Rritja e ngadaltë ekonomike e regjistruar gjatë vitit 2012 ka qenë një nga sfidat e konsolidimit fiskal të planifikuar për këtë vit buxhetor. Konsolidimi fiskal në vendet e Evropës Juglindore është mbështetur si në reduktimin e shpenzimeve ashtu edhe në rritjen e taksave⁴⁸. Megjithatë, masa e konsolidimit fiskal për vitin 2012 ndryshon konsiderueshëm nga njëri vend tek tjetri (grafiku 6, djathtas), në varësi të objektivave kombëtarë për borxhin publik dhe krijimin e hapësirave fiskale në të ardhmen.

⁴⁸ Për detaje EC, *Public finances in EMU*, 2012.

5. PËRFUNDIME

BKC, pavarësisht vështirësive në procesin e llogaritjes apo të interpretimit, është indikator mjaft i rëndësishëm në analizimin dhe monitorimin e situatës fiskale në vend. Kjo për faktin se ky tregues i politikës fiskale shmanng marzhin e shkaktuar mbi balancën buxhetore nga faktorët ciklikë në ekonomi. Projektionet e sakta për hendekun e prodhimit dhe elasticitetit të treguesve buxhetorë favorizojnë BKC-në si një ankorë e duhur e politikës fiskale. Në të njëjtën kohë, shënjestrimi i BKC-së si një rregull fiskal i shërben dhe qëndrueshmërisë fiskale të vendit, pasi ky lloj rregulli fiskal lë hapësirë për politikë fiskale kundërciklike. Megjithatë, nuk mungojnë dhe disavantazhet që ofron një tregues i tillë, të cilat më së shumti lidhen me mënyrën e llogaritjes dhe interpretimit të tij. Në momentin e gjetjes së një kompromisi për mënyrën e llogaritjes dhe interpretimit të rezultateve lidhur me elasticitetet buxhetore dhe hendekun e prodhimit, mund të bëhen projeksione për BKC-në në funksion të vendimmarrjes. Gjithsesi, duhet theksuar se për t'i shërbyer një vendimmarrjeje më eficiente, saktësia e parashikimeve për këtë indikator kushtëzohet dhe nga implementimi i përpiktë i planeve të hartuara për treguesit buxhetorë, në periudhën në vijim.

Bazuar në metodologjinë e ndjekur dhe supozimet e ngritura për këtë studim për rastin e Shqipërisë, vlerësimet për elasticitetet buxhetore rezultuan të ngjashme me ato që sugjerojnë literatura ekonomike dhe vlerësime të tjera të mëparshme të kryera në rastin e Shqipërisë. Vlerësimet për BKC-në bazuar në parametrat e llogaritjes për elasticitetet buxhetore janë të rrethuara me paqartësi, për sa kohë ato mbështeten në një numër të konsiderueshëm supozimesh dhe mbartin dhe efekte që mund të vijnë nga thyerjet strukturore në ekonomi.

Pozicioni fiskal i parë në këndvështrimin e vlerave nominale për deficitin buxhetor nuk rezultoi i njëjtë me atë të vlerësuar nëpërmjet BKC-së. Rezultatet për BKC-në në rastin e Shqipërisë tregojnë se në periudhën e marrë në konsideratë politika fiskale, ndryshe nga argumentet normativë, ka qenë më së shumti e një natyre prociklike, duke shfaqur në këtë mënyrë sjellje të ngjashme me ekonomitë e vendeve në zhvillim. Karakteri prociklik i politikës fiskale në

Shqipëri u vërtetua empirikisht dhe nga ekuacioni i regresit i cili kuantifikonte dimensionin ciklik dhe atë diskrecionar të politikës fiskale. Ndërkaq, stabilizatorët automatikë kanë vepruar në një masë marxhinale në zbutjen e luhatjeve në prodhim, si pasojë e kombinimit të disa faktorëve njëherazi që lidhen me raportin e ulët të të ardhurave tatimore ndaj PBB-së, sistemin tatimor në fuqi, mungesën e një luhatshmërie të lartë të vlerësuar për hendekun e prodhimit, si edhe me madhësinë e moderuar të sektorit publik në krahasim me vendet e tjera.

Nisur nga kufizimet e krijuara nga baza e të dhënave gjatë periudhës së përgatitjes të këtij materiali, gjykojmë se në të ardhmen duhen bërë përpjekje drejt përmirësimit të metodës aktuale të ndjekur, në funksion të llogaritjes sa më të saktë të këtij indikator, si në aspektin e vlerësimit të hendekut të prodhimit, ashtu edhe të sensitivitetit buxhetor. Në këtë kontekst, ndër të tjera, gjykojmë se vlerësimi i elasticiteteve afatshkurtra, apo përmirësimi i metodës së ndjekur duke zëvendësuar supozimet e kryera me vlerësime ekonometrike do të rriste saktësinë e sensitivitetit buxhetor, duke përmirësuar rezultatet mbi BKC-në. Gjithashtu, një aspekt tjetër i rëndësishëm që do të trajtohet në të ardhmen është evidentimi i masave me karakter të përkohshëm, në mënyrë që efekti i tyre t'i hiqet BKC-së, për të përfutur një tablo më të saktë të pozicionit buxhetor strukturor.

SHKURTIME

KE: Komisioni Evropian – European Commission

EMU: Economic and Monetary Union - Bashkimi Ekonomik dhe Monetar

BE: Bashkimi Evropian – European Union

BQE: Banka Qendrore Evropiane - European Central Bank

FMN: Fondi Monetar Ndërkombëtar - International Monetary Fund

SGP : Stability and Growth Pact – Pakti i Rritjes dhe Stabilitetit

*OECD: Organisation for Economic Cooperation and Development
– Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim*

CESEE: Central Eastern and South Eastern Europe

LITERATURA

Alesina, A. and G. Tabellini (2005), "Why is fiscal policy often procyclical?" CESifo Working Paper No. 1556.

Auerbach, A. and Feenberg, D. (2000), "The significance of federal taxes as automatic stabilizers", NBER Working Paper No. 7662.

Akyüz, Y. (2007), "Debt Sustainability in Emerging Markets: A Critical Appraisal", DESA Working Paper No. 61.

Baungsgaard, Th. and Symansky, S. (2009), "Automatic fiscal stabilizers", IMF SPN/ 09/23.

Bezdek, V., Dybczak, K. and Krejdl, A. (2003), "Cyclically adjusted fiscal balance – OECD and ESCB methods", Czech Journal of Economics and Finance, No.53.

Blanchard, O. (1990), "Suggestions for a new set of fiscal indicators", OECD Economics Department Working Paper no. 79.

Boije, R., (2004) "The general government structural budget balance", Sveriges Riksbank Economic Review 1 / 2004.

Bornhorst, F, Dobrescu, G, Fedelino, A., Gottschalk, J., and Nakata, T., (2011) "When and How to Adjust Beyond the Business Cycle? A Guide to Structural Fiscal Balances", IMF Technical Notes and Manuals.

Bouthevillain, C., P. Cour-Thimann, G. van den Dool, P. Hernandez De Cos, G. Langenus, M. Mohr, S. Momigliano and M. Tujula (2001), "Cyclically-adjusted Budget Balances: An Alternative Approach", ECB, Working Paper, No. 77.

Brunila, A., J. Hukkinen, and M. Tujula (1999), "Indicators of the Cyclically Adjusted Budget Balance: The Bank of Finland's Experience", Bank of Finland Discussion Paper, No 99/1.

Burnside, C. (2004), "Assessing New Approaches to Fiscal Sustainability Analysis", Working Paper written for World Bank Latin America and Caribbean Department's report on Debt Sustainability Analysis.

Cajner, T., (2005) "Cyclically adjusted budget balances in Slovenia", Prikazi in analize XII/2, November, Ljubjana.

Cerra V. and Saxena S. C (2003) "Alternative Methods of Estimating Potential Output and the Output Gap", NBP Conference- Potential Output and Barriers to Growth, Zalesie Górne.

Chalk, N., (2002) "Structural balances and all that: Which indicators to use in assessing fiscal policy", IMF Working Paper, No.101.

Cottarelli C. and Fedelino A., (2010) "Automatic stabilizers and the size of government: Correcting a common misunderstanding", IMF Working Paper, no.155.

Croce, E. (2002) "Assessment of the Fiscal Balance", in Macroeconomic Management Programs and Policies, IMF.

Debrun X. and Kapoor R., (2010), "Fiscal policy and macroeconomic stability: Automatic stabilizers work always and everywhere", IMF Working Paper, No.111.

Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009, Banka e Shqipërisë.

Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012, Banka e Shqipërisë.

Dos Reis, L., P.Manasse, and U.Panizza (2007), "Targeting the structural balance", IDB Research Department Working PaperNo. 598.

Dushku, E. dhe Kota, V. (2007), "Metoda alternative të matjes së produktit potencial në Shqipëri", material diskutimi i Bankës së Shqipërisë.

European Central Bank, (2010), "Monthly Bulletin", June 2010.

European Commission, (2009), "Achieving and safeguarding sound fiscal positions", Economic papers No.377.

European Commission, ECFIN/B/6, (2005), "New and updated budgetary sensitivities For the EU budgetary surveillance", REP54508.

European Commission, DG ECFIN, (2008), "Cyclical Adjustment of Budget Balances" REP 51941.

European Commission, (2006), "Public Finances in EMU", European Economy, 2006.

European Commission, (2009), "Public Finances in EMU", European Economy, May 2009.

European Commission, (2010), "Public Finances in EMU", European Economy, May 2010.

European Commission, (2012), European Economic Forecast, European Economy 7, Economic and Financial Affairs, Autumn 2012

Fatas, A. and I.Mihov (2009), "The euro and fiscal policy" NBER Working Paper, No 14722.

Fedelino A., Ivanova A. and Horton M. (2009) "Computing cyclically adjusted balances and automatic stabilizers", IMF Technical Notes and Manuals.

Giorno C., Richardson, P., Roseveare D. and Noord van den P., (1995), "Potential output, output gaps and structural budget balances", OECD Economic Studies, No.24

Girouard, N. and C. André (2005), "Measuring cyclically-adjusted budget balances for OECD countries", Economics Department Working Paper No. 434.

Holm, P. and Somervouri H. (1997), "Structural unemployment in Finland", OECD Working Paper, no 177.

International Monetary Fund (2002), "Assessing Sustainability", Policy Development and Review Department.

Këshilli i Ministrave RSH, VKM Nr.544, datë 01.08.2012 "Kuatri makroekonomik e fiskal për periudhën 2013-2015".

Kopits, G. and S. Symansky (1998), "Fiscal Rules", IMF Occasional Paper 162.

Kumar, M. Leigh, D. and Plekhanov, A. (2007), "Fiscal Adjustments: Determinants and Macroeconomic Consequences", IMF Working Paper, no 178.

Larch, M. and A.Turrini (2009), "The cyclically adjusted budget balance in EU fiscal policy making: A love at first sight turned into a

mature relationship”, EC Economic and Financial Affairs Department Economic Paper no. 374.

Ligji nr. 61, datë 24.5.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 7928 datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” si edhe amendimet e ndryshimet kryer në vite. http://www.tatime.gov.al/gdt/Value_Added_Tax_%28VAT%29.aspx

Ligji “Për akcizat” dhe amendimet e ndryshimet në vite: http://www.tatime.gov.al/gdt/Excise_Duties_in_Republic_of_Albania.aspx

Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe amendimet e ndryshimet në vite: http://www.tatime.gov.al/gdt/Income_Tax.aspx

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, amenduar dhe ndryshuar me ligjin 8286, datë 16.02.1998. http://www.tatime.gov.al/gdt/Collection_on_compulsory.aspx

Luca A. and Cimadomo, J. (2009), “Discretionary Fiscal Policies over the Cycle. New Evidence based on the ESCB Disaggregated Approach”, ECB Working Paper, No. 1118.

Mançellari, A., (2011), “Efektet makroekonomike të politikës fiskale në Shqipëri: Vlerësim me modelin SVAR”, material diskutimi i Bankës së Shqipërisë.

Mankiw, G.N, (2002), “Macroeconomics, 5th edition”, New York, Worth Publishers.

Ministria e Financave, Legjislacioni tatimor në Shqipëri. http://www.minfin.gov.al/minfin/Legjislacioni_Tatimor_38_1.php

Mohanty, M.S. and Scatigna, M. (2003). “Countercyclical fiscal policy and central banks,” BIS Papers chapters, in: Fiscal issues and central banking in emerging economies, volume 20, pages 38-70 Bank for International Settlements.

Noord, P. van den, (2000), “The size and the role of automatic stabilizers in the 1990s and beyond”, OECD, Economics Department Working Papers, No. 230.

Projektbuxheti 2013 : http://www.minfin.gov.al/minfin/Projektbuxheti_per_vitin_2013_2358_1.php.

Raporti i politikës monetare për tremujorin e parë të vitit 2010, Banka e Shqipërisë.

Spilimbergo, A. , Symansky, S., and Schindler , M., (2009), "Fiscal multipliers", IMF Staff Position Note, No. 11.

Veld, J., Larch, M., and Vandeweyer, M., (2012), "Automatic fiscal stabilisers: What they are and they do", EC Economic Papers no 452.

Wolswijk, G. (2007), "Short run and long run elasticities. The case of Netherlands", ECB Working Paper, No. 763.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Anjeza Gazidede

Një mënyrë alternative e vlerësimit të pozicionit fiskal në rastin e Shqipërisë: balanca buxhetore e korrektuar për ciklet e biznesit - /

/Gazidede Anjeza - Tiranë:

Banka e Shqipërisë, 2013

-56 f; 15.3 x 23 cm.

Bibliogr.

ISBN: 978-99956-42-83-0.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

*Banka e Shqipërisë
Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 420 kopje